# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5682
E martë, 22 janar 2019
çmimi 0.40 €


## Meta dhe Gjukanoviqi kërkojnë finalizimin e dialogut në Bruksel

FAQE 8-9




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


PRESIDENTI I KOSOVËS, HASHIM THAÇI, KA PRITUR NË TAKIM KRYESUESIT E EKIPIT NEGOCIATOR, FATMIR LIMAJN DHE SHPEND AHMETIN FAQE 4-5

# Thaçi koordinohet me ekipin negociator, kërkon shtim të dialogut



Presidenti Hashim Thaçi është takuar të hënën me kryesuesit e ekipit negociator, Fatmir Limajn dhe Shpend Ahmetin, me të cilët ka diskutuar për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi. Në funksion të koordinimit dhe harmonizimit të veprimeve shtetërore, Thaçi i ka dorëzuar ekipit negociator dokumentet zyrtare për temat që janë diskutuar deri më tani në këtë proces. Në një konferencë me gazetarë, Thaçi ka bërë me dije se me ekipin negociator janë pajtuar që ky proces, i cili kërkon unitet shoqëror dhe konsensus politik, duhet të përfundojë me marrëveshje gjithëpërfshirëse, e cila do t'i sigurojë Kosovës njohjen nga Serbia dhe anëtarësimin në OKB

## SBAShK-u vazhdon grevën




Greva në arsim ka hyrë në javën e dytë pasi që Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBAShK) nuk e ka pranuar ofertën e Qeverisë për rritje të pagave për mësimdhënësit prej 10 përqindësh për katër nivele të arsimit. Zyrtarët e SBAShK-ut janë shprehur të vendosur për ta vazhduar grevën deri në realizimin e kërkesave të tyre, kurse kryeministri Ramush Haradinaj i ka ftuar të reflektojnë, duke thënë se rritja e ofruar është e vetmja mundësi buxhetore

FAQE 4-5




## Fillon procesi i tranzicionit të FSK-së në ushtri

FAQE 6

## AKTUALE

### DONI TË BËNI KËMBIM TERRITORESH? ATËHERË BËJENI SIPAS KUFIJVE KADASTRALË TË KOMUNAVE! F. 12



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

### BETOHEN 37 GJYQTARË TË RINJ F. 3

### MUSTAFA: IBRAHIM RUGOVA I KRIJOI KOSOVËS SHUMË MIQ ANEKËND BOTËS F. 3

## EKONOMI



### HARADINAJ: INVESTITORËT NË KOSOVË KANË PARTNERË DHE NUK JANË VETËM F. 9

### MINISTRI BEQAJ MERR PJESË NË FORUMIN WORLD BUSINESS ANGELS NË KROACI F. 8

## SPORT

### HALITI: E INKUADROJ DUKAGJININ NË SUPERLIGË PASTAJ PENSIONOHEM F. 16

### SADIKU: REFUZOVA SPANJËN DHE TURQINË PËR LUGANON F. 16


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Rama paralajmëron "luftë" me Metën në Kushtetuese

Tiranë, 21 janar - Me 78 vota pro deputetët e qeverisë votuan të hënën në Kuvend, që kryeministri Edi Rama të marrë zyrtarisht detyrën si ministër i Jashtëm, ndërkohë që është votuar me 77 vota edhe dekreti i presidentit Ilir Meta, për shkarkimin e Ditmir Bushatit nga ky post.
Vota abstenim ka qenë nga deputeti Spartak Braho, ndërsa vetë ish-kryediplomati ka votuar pro shkarkimit të tij.
Në një prononcim për mediet jashtë sallës së Kuvendit, Rama tha se çështja e refuzimit të dekreteve nga Kreu i Shtetit ka shtyrë PS-në që t'i adresohet Gjykatës Kushtetuese dhe për këtë janë përgatitur një sërë padish që pritet të dorëzohen së shpejti.
"Dua të them se votimi i sotëm ishte rezultat i një zgjedhje të detyruar si pasojë e refuzimit të presidentit për të dekretuar ministrin e Jashtëm dhe thënë kjo, dua ta bëj të qartë për gjithë opinionin se nuk ka një gjykatë Kushtetues ende dhe në pritje të formimit të Gjykatës Kushtetuese për të trajtuar në rrugë institucionale shkeljen e saj nga presidenti. U detyrova të marr ketë vendim se projekti i qeverisë re nuk duhet të cenohet. Kemi përgatitur padi. Do të ketë një numër padish në Gjykatën Kushtetuese për presidentin e Republikës, i cili ka marrë përsipër të punojë në kundërshtim me traditën e asaj zyre. Askush nuk e ka bërë këtë më parë", tha Rama.



Presidenti i Shqipërisë Ilir Meta po qëndron për vizitë zyrtare në Mal të Zi

# Meta dhe Gjukanoviqi kërkojnë finalizimin e dialogut në Bruksel

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta dhe homologu i tij malazias, Milo Gjukanoviq kanë thënë të hënën në Podgoricë që epilogu i dialogut në mes të Prishtinës dhe Beogradit duhet të rezultojë me marrëveshje, e cila nuk do të rrezikonte stabilitetin e rajonit



Podgoricë, 21 janar - Presidenti i Malit të Zi, Milo Gjukanoviq dhe ai i Shqipërisë, Ilir Meta, janë pajtuar të hënën në Podgoricë që epilogu i dialogut në mes të Prishtinës dhe Beogradit duhet të rezultojë me marrëveshje, e cila nuk do të rrezikonte stabilitetin e rajonit.
"Është bindja jonë se Maqedonia do ta shfrytëzojë shansin e saj. Kemi pasur një pjesë të vëmendjes edhe ndaj Bosnjë e Hercegovinës. Kemi biseduar për avancimin e të drejtave të pakicave të të dyja vendeve, e këto janë çështje që kurrë nuk zgjidhen. Pakica malaziase në Shqipëri dhe ajo shqiptare në Mal të Zi, janë urat lidhëse më të besueshmet të bashkëpunimit ndërshtetëror", ka thënë Gjukanoviqi.
Meta në Podgoricë është pritur me nderimet më të larta shtetërore. Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka arritur të hënën për vizitë zyrtare dyditore në mal të Zi, ku me nderimet më të larta shtetërore e ka pritur presidenti i Malit të Zi, Milo Gjukanoviqi.
Në konferencën për gazetarë Ilir Meta, tha se të dy vendet kanë çdo arsye për të ndërtuar themelet e një rruge të përbashkët.
"Marrëdhëniet tona janë shembull në rajon dhe jam krenar për kontributin e shqiptarëve në Mal të Zi,që ishin vendimtarë në mbështetjen e integrimeve euroatlantike të Malit të Zi", tha Meta.
Ai vuri në dukje se shqiptarët në Mal të Zi po ashtu kontribuuan në forcimin e paqes, sigurisë dhe stabilitetit.
"Të drejtat e shqiptarëve duhet të përmirësohen dhe të përfshihen më shumë në nivelin lokal dhe shtetëror. Ndërkohë që edhe në Shqipëri do të vazhdojmë angazhimin tonë në afirmimin e të drejtave të malazíasve", shtoi ai.
Meta veçanërisht përgëzoi përparimin e Malit të Zi drejt BE-së.
"Së shpejti në Tiranë do të organizohet samiti i Bërdo-Brionit, dhe me këtë rast shpreh vlerësimin tim në mbështetjen e Malit të Z, që e njohu Kosovën. Mali i Zi ka kontribuar dukshëm në zhvillimin e Ballkanit", tha Meta.
Presidenti shqiptar e vlerësoi si tejet të rëndësishëm dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës.
"Dialogu është i rëndësishëm për të gjithë rajonin dhe proceset integruese të Ballkanit Perëndimor", tha në fund presidenti shqiptar Ilir Meta.
Edhe presidenti malazias Milo Gjukanoviç theksoi marrëdhëniet e mira mes dy shteteve fqinje dhe bashkëpunimin ekonomik në të mirë të qytetarëve të të dy vendeve.
Meta është pritur me nderime të larta shtetërore nga Presidenti i Malit të Zi Gjukanoviq.
Me rastin e kësaj vizite, në rrugët e Podgoricës janë vendosur flamujt kuqezi për nder të Presidentit të Shqipërisë.
Gjatë kësaj vizite, përveç takimeve me zyrtarët e lartë të Malit të Zi, presidenti Meta do të vizitojë edhe qytetet ku jetojnë shqiptarët, Tuzin dhe Ulqinin, si dhe do të ndalet në Arqipeshkvinë e njohur të Tivarit.

## VMRO-ja dërgon në Kushtetuese Ligjin për shqipen

Shkup, 21 janar - Partia opozitare maqedonase, VMRO-DPMNE ka paraqitur në Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë kërkesën për anulimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, që avancon përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe.
Sipas opozitës maqedonase, ligji i miratuar nga shumica parlamentare, që ka hyrë në fuqi javën e kaluar "është jokushtetues dhe i dëmshëm për Maqedoninë".
VMRO-DPMNE-ja kërkon nga Gjykata Kushtetuese që sa më parë të shqyrtojë kërkesën e saj për vlerësimin e kushtetutshmërisë së këtij ligji që ka shkaktuar reagime të shumta në opinion.
"Dekreti i shpalljes së Ligjit për dygjuhësinë u botua vetëm me nënshkrimin e kryetarit të Kuvendit, Talat Xhaferit dhe pa nënshkrimin e presidentit të shtetit, Gjorgje Ivanov. Ky veprim është në kundërshtim të plotë me nenin 75 të Kushtetutës, i cili përcakton dekretet për shpalljen e ligjeve që do duhet të nënshkruhet nga presidenti i Republikës së Maqedonisë", tha Igor Janushev, sekretar i përgjithshëm i VMRO-DPMNE-së.
Sipas tij, Ligji për gjuhët është në kundërshtim me amendamentin 5 të Kushtetutës së Maqedonisë, ku thuhet se "në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare, gjuha zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik".



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Oferta e Qeverisë së Kosovës për rritje pagash nuk është pranuar nga punëtorët e arsimit

# SBAShK-u vazhdon grevën

Greva në arsim ka hyrë në javën e dytë pasi që Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBAShK) nuk e ka pranuar ofertën e Qeverisë për rritje të pagave për mësimdhënësit prej 10 përqindësh për katër nivele të arsimit. Zyrtarët e SBAShK-ut janë shprehur të vendosur për të vazhduar këtë grevë deri në realizimin e kërkesave të tyre, kurse kryeministri Ramush Haradinaj i ka ftuar të reflektojnë, duke thënë se rritja e ofruar është e vetmja mundësi buxhetore




EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 21 JANAR - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBAShK) ka refuzuar ofertën e Qeverisë së Kosovës dhe të kryeministrit Ramush Haradinaj për rritje pagash për mësimdhënësit në katër nivele të arsimit. SBAShK-u të hënën ka mbajtur takimin e Këshillit Drejtues, në të cilin ishin edhe kryetarët e sindikatave komunale parauniversitare si dhe kryetarët e universiteteve, ku kanë vendosur të vazhdojë greva në arsim edhe në javën e dytë. Në këtë mbledhje kryetari i SBAShK-ut, Rrahman Jasharaj, ka treguar se do të vazhdojë edhe më tej greva, sepse oferta e Qeverisë është tejet e ulët dhe pret reflektim nga Qeveria. "Me të drejtë ju thatë njëzëri se oferta e kryeministrit nuk pranohet për dy shkaqe, sepse oferta është tepër e ulët, nuk arrin as 10 për qind të koeficientit dhe kjo ofertë është e papranueshme sepse, me gjithë vlerën e ulët, janë bërë edhe përjashtime me apo pa arsye te një pjesë e sistemit arsimor. Duke dëgjuar deklaratat e juaja ne jemi bashkë që nga çerdhet, punëtorët teknikë ndihmës, mësimdhënësit, stafi administrativ në të gjitha nivelet, me gjithë stafin akademik e me drejtorin. Çdo zgjedhje të ofruar do ta analizojmë, por do të kërkojmë që kërkesa të bëhet jo për një pjesë, por për të gjithë", ka thënë Jasharaj. Kreu i SBAShK-ut ka deklaruar se tani i mbetet Qeverisë të reflektojë. "Grevën nuk mund ta mbyllë as ministri e as kryeministri, por njerëzit që e përfaqësojnë arsimin. Ne nuk e zgjodhëm grevën, por na u imponua", është shprehur ai. Ndërsa kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, i cili të dielën mbrëma ka prezantuar ofertën e Qeverisë për mësimdhënësit, përsëri ka bërë thirrje të hënën që të ndërpritet grevës dhe të rinisë procesi mësimor. "Vendimi i Qeverisë për ngritje të pagave për punëtorët e arsimit erdhi pas një procesi serioz të shqyrtimit buxhetor nga Qeveria e vendit dhe u finalizua me pajtimin e plotë të të gjitha partive politike në Komisionin Parlamentar për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media. Është vendim që sfidon seriozisht kapacitet buxhetore, por duke marrë parasysh rëndësinë që ka arsimi për të gjithë, mori përkrahje të gjerë", ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në "Facebook". Sipas tij, më nuk është etike që ndonjë punëtor i arsimit të ankohet për pagë të ulët. "Është e padrejtë dhe jo etike që pas këtij vendimi të mohohet e drejta e fëmijëve tanë për shkollim, aq më pak të ankohet ndonjë punëtor arsimi për pagë të ulët. Nuk është kohë pazaresh, por është koha që të fokusohemi në ngritje të cilësisë në arsim. Rritja e pagës është dinjitoze dhe pritjet racionale janë që edhe reflektimi të jetë dinjitozë. Mos i dënoni fëmijët tanë. Të nderuar punëtorë të arsimit, keni pagë të respektuar", ka shkruar ai.
Edhe ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqyri Bytyqi, ka treguar se të hënën ka takuar këshillin e grevës së SBAShK-ut për të diskutuar dhe informuar saktësisht lidhur me veprimin e fundit që Qeveria ka ndërmarrë për rritjen e koeficientit. "Sipas vendimit të fundit të Qeverisë dhe pajtimit të Komisionit Parlamentar, do të ketë rritje për të gjithë sistemin arsimor parauniversitar me koeficientin 0.20, pra rritja e një koeficienti që përkthyer në shifra i bie rreth 48 euro për secilin mësimdhënës, duke u bazuar në pagën aktuale që sot kanë. SBAShK-u vazhdon t'i ketë kërkesat që i ka pasur që në fillim. Konsideroj se nuk e ka të qartë se nuk është çështje diskutimesh, por mundësi buxhetore", ka shkruar Bytyqi në profilin e vet në "Facebook".
Lidhur për grevën në arsim dhe shëndetësi ka reaguar edhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj). Ky institucion ka vlerësuar se SBAShK-u dhe mjekët janë duke shkelur të drejtat në këta dy sektorë.

## Kjo është oferta e kryeministrit për SBAShK-un

Oferta e Qeverisë për mbi 20 mijë të punësuar në sektorin e arsimit kap vlerën rreth 20 milionë euro në vit. Sipas ofertës së Qeverisë së Kosovës, kjo është rritja e pagave për katër kategoritë e mësimdhënësve: Për 5 000 mësimdhënës në shkollat e mesme, nga 74.8 euro më shumë në muaj;
për 14.790 mësimdhënës në arsimin fillor, nga 46.8 euro më shumë në muaj; për 912 mësimdhënës ne arsimin parashkollor, nga 49.8 euro më shumë në muaj; për 125 mësimdhënës në shkollat speciale, nga 49.8 euro më shumë në muaj.

## Presidenti bën thirrje për dialog social

Presidentin i vendit, Hashim Thaçi, ka ftuar Qeverinë dhe përfaqësuesit e sindikatave që ta nisin dialogun social për të gjetur zgjidhje për të gjitha çështjet. "Sa iu përket grevave të mësimdhënësve e të punëtorëve të shëndetësisë, i kuptoj vendimet e Qeverisë së Kosovës, respektoj të drejtën për protestë dhe grevë, por i inkurajoj palët për dialog social. Jam kundër veprimeve të njëanshme, pra insistoj dhe i inkurajoj palët për dialog social. Me ata njerëz kam punuar gjatë, i njoh, janë njerëz të mirë dhe kur të ulesh, merresh vesh me ta", ka thënë Thaçi në një konferencë për medie.

# UP-ja mbështet grevën në institucionet arsimore

PRISHTINË, 21 JANAR (ER) - Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" ka mbajtur të hënën takimin e Kolegjiumit të Dekanëve, ku është diskutuar çështja e grevës në arsim. Me këtë rast, UP-ja ka njoftuar studentët, personelin dhe gjithë opinionin, se e mbështet grevën në institucionet arsimore. "Si rrjedhojë, UP-ja shtynë të gjitha aktivitetet akademike dhe administrative për një afat të pacaktuar, duke përfshirë këtu edhe mbajtjen e provimeve të afatit të janarit në të gjitha njësitë akademike të Universitetit. Duke shpresuar që në një afat të shkurtër kohor do të arrihet zgjidhja e duhur për situatën e krijuar, deri në njoftimin e radhës ky është qëndrimi zyrtar i Universitetit", është thënë në komunikatën e UP-së.



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur në takim kryesuesit e ekipit negociator, Fatmir Limajn dhe Shpend Ah

# Thaçi koordinohet me ekipin nego



**Presidenti Hashim Thaçi është takuar të hënën me kryesuesit e ekipit negociator, Fatmir Limajn dhe Shpend Ahmetin, me të cilët ka diskutuar për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi. Në funksion të koordinimit dhe harmonizimit të veprimeve shtetërore, Thaçi i ka dorëzuar ekipit negociator dokumentet zyrtare për temat që janë diskutuar deri më tani në këtë proces. Në një konferencë me gazetarë, Thaçi ka bërë me dije se me ekipin negociator janë pajtuar që ky proces, i cili kërkon unitet shoqëror dhe konsensus politik, duhet të përfundojë me marrëveshje gjithëpërfshirëse, e cila do t'i sigurojë Kosovës njohjen nga Serbia dhe anëtarësimin në OKB**

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 21 JANAR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të hënën i ka dorëzuar ekipit negociator dokumentet zyrtare për procesin e deritanishëm të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Pas takimit me bashkëdrejtuesit e ekipit negociator, Fatmir Limaj dhe Shpend Ahmeti, presidenti Thaçi në një konferencë për medie ka bërë me dije se ky dokument përfshinë sfondin e fazës përfundimtare të dialogut Kosovë - Serbi dhe pozicionet e përgjithshme të palës kosovare në takimet e zhvilluara me përfaqësuesit e Bashkimit Evropian në Bruksel. "Ky dokument informues përfshinë çështje specifike të diskutuara në kuadër të fazës përfundimtare, si: personat e pagjetur, pastaj çështjen e personave të zhvendosur, për të vazhduar në trashëgiminë kulturore, çështjen e pronave, të drejtën e komuniteteve joshumicë, kthimin e artefakteve arkeologjike dhe etnologjike të Kosovës. Gjithashtu, është kërkuar që të gjitha marrëveshjet e arritur në kuadër të dialogut teknik dhe politik në periudhën 2011-2015 duhet të zbatohen si pjesë e marrëveshjes gjithëpërfshirëse", ka deklaruar Thaçi, duke shtuar se bartësit e institucioneve të Kosovës do të punojnë së bashku për realizimin e objektivave sipas Kushtetutës, ligjeve dhe vullnetit të qytetarëve të Kosovës. "Synimi i Kosovës mbetet që në javët dhe muajt e ardhshëm të arrihet një marrëveshje gjithëpërfshirëse ligjërisht obliguese në rrafshin ndërkombëtar, që garantohet pranimi i Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, si dhe njohja nga Serbia. Do të ketë kufij sipas standardeve evropiane, Kosova dhe Serbia do të mbesin shtete shumetnike dhe nuk do të ketë kufi në baza etnike", është shprehur Thaçi.

Pavarësisht prej vështirësive, ai ka thënë se marrëveshja përfundimtare do të arrihet dhe pjesë e saj do të jetë edhe përfshirja e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës me Kosovën. "Besoj se diçka e tillë me vështirësi shumë të mëdha mund të arrihet. E di se do të ketë pengesa, vështirësi, ballafaqime dhe kokëdhimbje të ndryshme, por besoj në udhëheqjen e BE-së dhe në mbështetjen e plotë dhe të sinqertë të ShBA-së. Vazhdoj të besoj edhe më fuqishëm se herëve të tjera që në marrëveshjen përfundimtare do të kemi përfshirjen e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit me Kosovën. Garantoj se për t'i shuar të gjitha spekulimet edhe Liqeni i Gazivodës, edhe veriu i Mitrovicës, edhe Trepça do të jenë pjesë e Kosovës", ka theksuar Thaçi, duke shtuar se tani është momentumi që spektri politik të jetë i bashkuar dhe të punojë fuqishëm. "Prandaj do të punojmë shumë ngushtë dhe në ditët e ardhshme do të jem në ShBA që ta shtojmë procesin në mënyrë që të shkojmë drejt një vendimmarrje historike, paqësore dhe përfundimtare. Të gjithë duhet të fokusohemi se mbi ndonjë veprim taktik elektoral apo ditor të marrim orientim dhe vendime strategjike për shtetin e Kosovës. Veprim më strategjik sesa kultivimi dhe fuqizimi i raporteve me ShBA-në nuk ka. Raportet me ShBA-në janë më të rëndësishme sesa çdo interes momental. Kosovës as liria dhe as pavarësia nuk i vyen kurrgjë pa mbështetjen e Amerikës. Nuk dëshiroj ta jetojë kohën kur në

metin

# ciator, kërkon shtim të dialogut



Kosovë do të ketë një politikë jokoordinuese vendimmarrëse me ShBA-në", ka thënë ai.

Në këtë kuadër presidenti Thaçi ka treguar se i ka dërguar presidentit Trump një letër përmes së cilës ka ritheksuar përkushtimin e Kosovës për të qenë pjesë e dialogut për arritjen e marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi. "Me rëndësi është që ne mos të gabojmë, ne të jemi unikë, të marrim vendime bashkërisht me ShBA-në, BE-në dhe jam i bindur se do të kemi sukses. Në vend të ankesave në raport me Serbinë ne duhet të punojmë me botën perëndimore, ta arrijmë marrëveshjen përfundimtare, Serbia rrugën e vet e ne rrugën tonë. Përderisa nuk kemi marrëveshje do të kemi probleme të vazhdueshme. Por, ne si liderë nuk e kemi të drejtën as morale, as kombëtare e as kushtetuese t'u lëmë probleme gjeneratave të ardhshme", ka deklaruar presidenti.

Në këtë konferencë Thaçi ka folur edhe për çështjen e taksës ndaj produkteve serbe, duke thënë se Serbia meriton edhe më shumë se kaq, mirëpo Kosova duhet të shikojë më larg dhe të mos e rrezikojë partneritetin me miqtë ndërkombëtarë. "Kosova nuk duhet të vendosë pengesa apo vështirësi për dialog dhe ta forcojë imazhin negativ para miqve tanë. Ne duhet të prodhojmë argumente pozitive, e jo elemente negative në raport me miqtë dhe partnerët tanë. Nuk duhet ta lejojmë që Serbia të krijojë favore të panevojshme për shkak të zhvillimeve. Serbia meriton përtej taksës. Serbia meriton ndëshkimin nga bashkësia ndërkombëtare për të gjitha krimet e bëra në Kosovë. Ajo meriton edhe më tepër nga ne, por ne duhet të shikojmë më larg sesa politikat momentale. Çdoherë kur kemi bashkëpunuar me bashkësinë ndërkombëtare, NATO-n e ShBA-në, nuk kemi humbur. Aty ku do të jenë ShBA-ja dhe BE-ja do të jemi edhe ne. Askush prej miqve tanë nuk e dëshiron lëndimin e shtetit të Kosovës, por e dëshiron avancimin dhe, tekefundit, kush jemi ne, çfarë kaçiku kemi ne për t'i penguar ShBA-në, BE-në dhe NATO-n në angazhimet për paqe të përgjithshme në Ballkanin Perëndimor", ka thënë Thaçi.

## Limaj e Ahmeti marrin garanci nga presidenti se nuk ka draft marrëveshje të arritur në dialogun e Brukselit

Pas takimit, kryesuesi i ekipit negociator, Shpend Ahmeti, ka thënë se presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka siguruar ata se nuk ka asnjë draft zyrtar qoftë me Brukselin, qoftë me Serbinë, në lidhje me procesin e ardhshëm të dialogut në Bruksel. "Ky është një raport i presidencës për delegacionin shtetëror dhe nuk është dokumentacion i cili është dakorduar apo është diskutuar me Brukselin. Pra, na është raportuar mbi temat që janë diskutuar, nuk është transkriptim i takimeve që presidenti Thaçi ka pasur atje, por është një raportim i ekipit të Thaçit për temat e ndryshme që janë hapur në Bruksel si pjesë e fazës përfundimtare. Në këto çështje figurojnë temat siç janë ato për çështjen e të zhdukurve, të zhvendosurve, pastaj për trashëgiminë kulturore, pronat dhe të drejtat e minoriteteve", ka deklaruar Ahmeti, duke shtuar se së shpejti do të zhvillohet edhe vizita e dytë e delegacionit të Kosovës në Bruksel për të diskutuar me zyrtarët e BE-së për dialogun.

Edhe bashkëkryesuesi i ekipit negociator, zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, ka thënë se nuk kanë marrë shumë dokumente nga presidenti Thaçi dhe se pak a shumë, sipas tij, do të fillohet nga zeroja për ndërtimin e platformës për bisedime me Serbinë. "Realisht nuk kemi marrë shumë dokumente. Duhet të fillojmë nga zero për të paraqitur qëllimin e Kosovës. Kjo do të jetë korniza jonë e dialogut të mundshëm Kosovë - Serbi. Për ne si delegacion shtetëror tani e dimë ku jemi si shtet në këtë proces. Ky ka qenë edhe qëllimi ynë që të kemi të qartë se në çfarë pike po fillojmë në mandatin që e kemi. Duhet të fillohet nga zeroja, për ta filluar ndërtimin e bashkëbisedimit të temave që u theksuan nga Ahmeti. Ne morëm dokumentacionin nga presidenti Thaçi. E kemi marrë një draft-propozim nga kryeministri dhe me këtë po ndërtohet një dosje për të ecur përpara në procesin e dialogut me Serbinë. Ajo që ne morëm në përfundim është se, përveç bisedimeve që janë bërë më tepër me Brukselin sesa me Serbinë, nuk ka pasur ndonjë marrëveshje të arritur", ka deklaruar Limaj.

# Krasniqi, Apostolovës: PDK-ja po angazhohet për konsensus rreth dialogut me Serbinë

**Prishtinë, 21 janar (ER)** - Agjenda legjislative për këtë vit, reformat në sektorë të ndryshëm që ndërlidhen edhe me agjendën integruese të Kosovës në Bashkimin Evropian, dialogu me Serbinë dhe tema të tjera, u diskutuan të hënën në mes të kryetarit të grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi dhe shefes së Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova.

Në këtë takim të pranishëm ishin edhe deputetët Elmi Reçica, Blerta Deliu-Kodra dhe Sala Berisha-Shala. Krasniqi e ka njoftuar Apostolovën edhe për qëndrimin e PDK-së pro dialogut me Serbinë, me synimin që të arrihet një marrëveshje ndërkombëtare obligative. Ai ka theksuar angazhimin e PDK-së për një konsensus të plotë të spektrit politik të Kosovës rreth dialogut.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Memli Krasniqi, ka folur edhe për përkushtimin e PDK-së në Kuvend që të ketë angazhim edhe më të madh në reforma të rëndësishme për vendin si në sundimin e ligjit, ekonomi, arsim dhe fusha të tjera. Për këtë, ka theksuar Krasniqi, do të ketë bashkëpunim të ngushtë edhe me Bashkimin Evropian dhe partnerë të tjerë.



# Mustafa: Ibrahim Rugova i krijoi Kosovës shumë miq anekënd botës

"Presidenti Rugova punoi për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës. Ai i krijoi Kosovës shumë miq anekënd botës", kështu ka thënë kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, me rastin e 13-vjetorit të vdekjes së ish-presidentit Ibrahim Rugova në akademinë përkujtimore të organizuar nga kjo parti politike




**Prishtinë, 21 janar (ER)** - Qindra zyrtarë dhe simpatizues së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) kanë nderuar të hënën kujtimin dhe veprën e ish-presidentit Ibrahim Rugova me rastin e 13-vjetorit të vdekjes së tij.

Lidhja Demokratike e Kosovës në një akademi përkujtimore ka kujtuar krijimtarinë politike dhe letrare të ish-presidentit Rugova.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, ka thënë se trembëdhjetë vjet më parë Kosova në mënyrë madhështore ia dha lamtumirën e fundit ish-presidentit Rugova. "Rugova lindi dhe mbeti njeri i këtij vendi, i popullit shqiptar dhe i dheut të Kosovës. Filozofia e tij politike dhe veprimtaria krijuese kapërceu pashmangshëm kufijtë e Ballkanit dhe u bë e pranuar dhe e admiruar nga civilizimi evropian dhe ai botëror", ka thënë Mustafa.

Ai ka shtuar se ish-presidenti Rugova ka krijuar platformën politike për republikën e pavarur dhe sovrane të Kosovës, anëtare të Bashkimit Evropian dhe të NATO-s dhe në miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Presidenti Rugova punoi për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës. Ai i krijoi Kosovës shumë miq anekënd botës", ka thënë ai.

Mustafa ka thënë se LDK-ja po punon me përkushtim të veçantë për t'i realizuar prioritetet e saj të cilat me vizionin dhe largpamësinë e tij mbresëlënëse i kishte parashikuar dhe promovuar ish-presidenti Ibrahim Rugova.

"LDK-ja i mbetet besnike fuqizimit të partneritetit dhe miqësisë së përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e tjera perëndimore. LDK-ja do të angazhohet me vendosmëri dhe konsistencë që ta ndjekë rrugën integruese të Kosovës në strukturat euroatlantike, që është alternativa e vetme perspektive për qytetarët dhe shtetin e Kosovës, e formuluar si e tillë nga vetë presidenti Rugova. Ne vazhdojmë të jemi besnikë të paqes, mirëkuptimit, dialogut konstruktiv si mjet për zgjidhjen e problemeve brenda dhe jashtë vendit, por edhe të vendosur ta ruajmë shtetësinë tonë. Ta ruajmë Kosovën në kufijtë në të cilët e ka shpallur pavarësinë, ta forcojmë identitetin e brendshëm dhe të jashtëm të shtetit të Kosovës", ka thënë Mustafa.

## Thaçi, Haradinaj, Sejdiu e shumë zyrtarë të tjerë bënë homazhe te varri i Rugovës

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, me rastin e 13-vjetorit të vdekjes së ish-presidentit Ibrahim Rugova, ka bërë homazhe te varri i tij në Prishtinë. Thaçi ka thënë se ish-presidenti Rugova ishte një prej arkitektëve të pluralizmit politik të Kosovës. Po ashtu, ai ka thënë se Rugova ishte njeri i dialogut dhe marrëveshjeve.

Homazhe te varri i ish-presidentit Rugova ka bërë edhe kryeministri Ramush Haradinaj. "Rugova me rreshtimin përkrah Perëndimit dhe në miqësi të përhershme me ShBA-në, ridëshmoi fuqinë e ideve demokratike shqiptare në shtetkrijim. Në përvjetorin e 13 të ndarjes nga jeta të presidentit historik, Kosova idealin e tij dhe të shumë brezave e ka kurorëzuar përmes unifikimit, që u manifestua me krijimin e ushtrisë sonë. Ushtarët e Ibrahim Rugovës dhe të Adem Jasharit tani janë në rresht me ushtritë e paqes, nën flamurin e Republikës së Kosovës. Pusho i qetë, president!", ka thënë Haradinaj.

Edhe ish-presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, ka bërë homazhe te varri i ish-presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se në kujtesën kolektive Rugova do të kujtohet përherë si prijësi paqësor dhe themeltar i shtetit të Kosovës.

# Filloi trajnimi bazik i kadetëve të Policisë së Kosovës




**Prishtinë, 21 janar (ER)** - Në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike të hënën filloi trajnimi bazik i gjeneratës së 54-t të Policisë së Kosovës. Kolonel Milorad Corac, drejtor i Departamentit për Trajnime në Drejtorinë e Përgjithshme, si dhe instruktorët e Policisë së Kosovës në akademi, u dëshiruan mirëseardhje kadetëve të rinj dhe i inkurajuan ta japin maksimumin që trajnimin bazik ta përfundojnë me sukses. Kadetët e rinj do të trajnohen sipas planprogrameve të dizajnuara në bazë të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe sundim të ligjit.

Trajnimin, i cili do të zgjasë deri në shtator, do ta vijojnë 430 kadetë të Policisë së Kosovës.



## Për tri ditë në Emergjencë u trajtuan 565 raste

**Prishtinë, 21 janar (ER)** - 565 persona kanë kërkuar ndihmë mjekësore gjatë tri ditëve në Klinikën Emergjente të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Sipas raporteve të punës, gjatë kësaj periudhe 86 pacientë janë trajtuar në dhomën e reanimimit, gjersa kishte 110 raste kirurgjike, 179 raste internistike dhe 159 raste ishin në dhomën e ortopedisë. Si pasojë e aksidenteve në trafik, 16 persona kanë kërkuar ndihmë mjekësore. Me udhëzim të mjekëve, në reparte të ndryshme të QKUK-së, janë shtrirë 66 pacientë për ta vazhduar trajtimin.

Të hënën është vendosur pllaka me mbishkrimin Ministria e Mbrojtjes

# Fillon procesi i tranzicionit të FSK-së në ushtri

**Ministri i Mbrojtjes, Rrustem Berisha, pasi ka zbuluar pllakën me mbishkrimin Ministria e Mbrojtjes, ka bërë me dije se nga sot fillon procesi i tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri. Ministri i Mbrojtjes ka falënderuar të gjithë ata që kontribuuan që Ministria e Forcës së Sigurisë të shndërrohet në Ministri të Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë të shndërrohet në ushtri të Kosovës**




EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 JANAR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, së bashku me ministrin e Mbrojtjes, Rrustem Berisha dhe komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, kanë bërë të hënën zbulimin e pllakës me mbishkrimin Ministria e Mbrojtjes, ceremoni kjo e zhvilluar në Ministrinë e Mbrojtjes. Pas zbulimit të pllakës, kryeministri Haradinaj ka zhvilluar një takim me ministrin e Mbrojtjes, Rrustem Berisha, komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe përfaqësues të tjerë të Ministrisë së Mbrojtjes, të cilët i ka uruar për këtë fazë të re të funksionimit, duke vlerësuar se Forca e Sigurisë së Kosovës do të jetë forcë shumetnike dhe profesionale, e gatshme për të kontribuuar në forcimin e paqes dhe të stabilitetit në Kosovë, rajon dhe më gjerë.

Pas zbulimit të pllakës, ministri i Mbrojtjes, Rrustem Berisha, ka thënë se sot është një ditë e veçantë për këtë ministri, për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe për të gjithë qytetarët e Kosovës, pasi nga sot do të ndryshojë emërtimi i Ministrisë në Ministri të Mbrojtjes. Më pas, ministri Berisha ka falënderuar të gjithë ata që kontribuuan që Ministria e Forcës së Sigurisë të shndërrohet në Ministri të Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë të shndërrohet në ushtri të Kosovës. "Zyrtarisht që nga sot është dita e parë kur fillon procesi i tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri të Kosovës. Dua t'i falënderoj të gjithë partnerët ndërkombëtarë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përfaqësuesit e NATO-s që janë këtu, në veçanti dua ta falënderoj kryeministrin e Kosovës, i cili në vazhdimësi, në të gjitha etapat, e ka përkrahur transformimin e FSK-së dhe do të vazhdojë ta përkrahë edhe në procesin e tranzicionit", ka thënë ministri Berisha, duke shtuar se i tërë procesi i tranzicionit do të jetë një proces gradual, transparent dhe është paraparë një plan dhjetëvjeçar i arritjes së kapaciteteve të mbrojtjes.

Duke folur rreth mandatit të ri, ministri Berisha tha se Forca e Sigurisë së Kosovës do të jetë forcë shumetnike, profesionale që do të jetë e përfaqësuar nga të gjithë qytetarët e Kosovës, në interes të të gjithë qytetarëve të Kosovës, por edhe në interes të ndërtimit të paqes dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë. Ministri Berisha ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për mbështetjen dhe përkrahjen e dhënë në të gjitha etapat.

# Betohen 37 gjyqtarë të rinj



**Në një ceremoni solemne para presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, gjyqtarë të rinj, shtatë prej të cilëve nga komuniteti serb, kanë bërë betimin të hënën, duke u zotuar se do t'i qëndrojnë besnikë Republikës së Kosovës, Kushtetutës, ligjeve në fuqi dhe se do t'i respektojnë rregullat e etikës profesionale**

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 JANAR - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, të hënën ka dekretuar 37 gjyqtarë të rinj të Republikës së Kosovës. Në një ceremoni solemne para presidentit Thaçi, gjyqtarët e rinj, shtatë prej të cilëve vijnë nga komuniteti serb, janë betuar se gjatë kryerjes së detyrës do t'i qëndrojnë besnikë Republikës së Kosovës, Kushtetutës, ligjeve në fuqi dhe do të respektojnë rregullat e etikës profesionale si dhe do t'i kryejnë me besnikëri, në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme detyrat dhe funksionet që u janë besuar. "Sot është ditë e veçantë për Republikën e Kosovës sepse sistemit gjyqësor i bashkohen edhe tridhjetë e shtatë gjyqtarë të rinj. Kosova në vazhdimësi ka bërë dhe po bën reforma në sistemin gjyqësor, me të vetmin qëllim, që sistemi gjyqësor të funksionojë sa më mirë, që të kemi sundim të mirëfilltë të ligjit në shtetin tonë", u shpreh presidenti Thaçi.

Kreu i shtetit ka thënë se në vitin e kaluar është bërë një punë e madhe nga institucionet përgjegjëse për hartimin, miratimin dhe shpalljen e ligjeve të rëndësishme, që e kanë avancuar edhe më tej sistemin gjyqësor. "Shteti i Kosovës është ndërtuar mbi parimet kushtetuese, të gjithëpërfshirjes, të barazisë dhe të lirisë së secilit individ që ta realizojë vetveten dhe të kërkojë lumturinë e tij/saj pa iu cenuar asnjëherë e drejta që të jetë pjesë e shoqërisë së Kosovës. Republika e Kosovës ka miratuar masa adekuate për të promovuar një barazi të plotë dhe efektive ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore. Edhe sot dekretimi dhe betimi i këtyre gjyqtarëve pasqyron plotësisht natyrën shumetnike të Republikës së Kosovës", ka thënë presidenti Thaçi.

I pari i vendit ka shtuar se gjyqtarët kanë rol të madh në jetën e qytetarëve, në realizimin e të drejtave të tyre dhe në sigurinë e qasjes së barabartë në drejtësi, pa marrë parasysh dallimin e tyre gjinor, racor, fetar e kombëtar. Në supet e gjyqtarëve është një përgjegjësi e madhe, ka theksuar presidenti Thaçi, të cilën ka besim të plotë se do të dinë ta mbajnë dhe qytetarët e vendit tonë do ta ndiejnë veten të sigurt dhe të barabartë para ligjit.

# Ministri Beqaj merr pjesë në forumin World Business Angels në Kroaci




Prishtinë, 21 janar (ER) - Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, po merr pjesë në Forumin "World Business Angels" në Zagreb të Kroacisë. Ministri Beqaj, së bashku me ministrat e rajonit, ishte pjesë e panelit ministror me temën "Zhvillimi i një partneriteti global me qëllim të përfshirjes financiare dhe lehtësimin e qasjes në financat ndërkombëtare të startupeve, NVM-ve dhe bizneseve të mëdha". Ndër të tjera, ai theksoi se do të vazhdojë të përkrahë dhe inkurajojë ndërmarrësit e rinj, pasi beson fuqishëm se ata janë të vetmit të cilët mund të përballen dhe t'i trajtojnë disa prej sfidave më të mëdha me të cilat po përballet bota aktualisht. Ky forum do të zgjasë dy ditë dhe përfundon me pritjen nga presidentja e Republikës së Kroacisë, Kolinda Granar Kitarovic. Forumi i WBA u mbajt për herë të parë në Kroaci, ku mblodhi politikëbërës të nivelit të lartë, ekspertë të ekonomisë dhe ndërmarrës të cilët shkëmbyen përvojat dhe praktikat më të mira të shteteve të tyre.

# Klubi i Prodhuesve të Kosovës reagon ndaj skandalit të AQP-së




Prishtinë, 21 janar (ER) - Klubi i Prodhuesve të Kosovës përmes një komunikate për medie ka reaguar ndaj të gjitha atyre institucioneve që nuk janë duke i respektuar vendimet e ekzekutivit të vendit edhe pas vendimit për vendosjen e taksës prej 100 përqindësh ndaj produkteve serbe. "Për Klubin e Prodhuesve të Kosovës është e papranueshme që Agjencia Qendrore e Prokurimit, e cila ka bërë blerje në emër të agjencive të pavarura, ka hapur tender që të blejë produkte të cilat kanë origjinë nga Serbia", thuhet reagimin e këtij institucioni.

Ky reagim i Klubit të Prodhuesve të Kosovës ka ardhur pasi ditë më parë Agjencia Qendrore e Prokurimit ka kërkuar të blejë prodhime të Serbisë për t'i furnizuar disa institucione. "Institucionet e Republikës së Kosovës duhet t'u japin përparësi prodhimeve vendore gjatë prokurimit publik dhe kërkojmë që të ndryshohet Ligji për Prokurimi Publik, sepse edhe në bazë të MSA-së lejohet që t'u jepet përparësi prodhimeve vendore. Kjo praktikë zbatohet në shumicën e vendeve të regjionit dhe në vendet e BE-së", është theksuar në reagimin e Klubit të Prodhuesve.

Klubi i Prodhuesve shpreson që Qeveria do t'i marrë masat e duhura ndaj këtij veprimi.

# Ministri Rikalo merr mbështetje për Kosovën nga dy komisionarë të BE-së



Prishtinë, 21 janar (ER) - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nenad Rikalo, në kuadër të vizitës së tij në Berlin, është takuar me komisionarin për bujqësi, Phil Hogan, si dhe atë për siguri të ushqimit dhe shëndetësi, Vyetinis Andriukatis, me të cilët ka biseduar ekskluzivisht për procesin e integrimit evropian të Republikës së Kosovës për avancimin e sektorit të bujqësisë. Me këtë rast, ministri Rikalo ka marrë përkrahje të fuqishme nga të dy komisionarët për mbështetjen e Kosovës në të gjitha proceset e integrimit evropian. Po ashtu, ministri Rikalo është shprehur i gatshëm që përmes angazhimit të tij në ministri t'i përmbushë të gjitha kriteret që dalin nga MSA-ja, e gjitha kjo për një rrugëtim sa më të shpejtë të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian. Gjatë këtij takimi ministri ka prezantuar edhe të arriturat në sektorin e bujqësisë si dhe i ka njoftuar ata me programet e ministrisë për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural në përgjithësi.

# Haradinaj: Investitorët në Kosovë kanë partnerë dhe nuk janë vetëm



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka vizituar të hënën ndërmarrjen e re të Ferronikelit, ku ka parë nga afër zhvillimet në këtë kompani. "Investitorët në Kosovë kanë partnerë dhe nuk janë vetëm", ka thënë Haradinaj

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

DRENAS, 21 JANAR - "Investitorët në Kosovë kanë partnerë dhe nuk janë vetëm", kështu ka thënë kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, gjatë vizitës që i ka bërë të hënën ndërmarrjes së re Ferronikeli, ku ka parë nga afër zhvillimet në këtë kompani. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj, pasi ka falënderuar Grupin Balfin për investimin në ndërmarrjen Ferronikeli, ka thënë se kjo kompani është një prodhuese dhe eksportuese e madhe si dhe investim me rëndësi për Kosovën. "Janë disa vështirësi që do t'i kalojmë bashkë. Janë 800 të punësuar të rregullt dhe është interes yni që vështirësitë që i kemi t'i tejkalojmë bashkë. Njëkohësisht, është interes yni ta përçojmë porosinë që investitorët në Kosovë kanë partnerë dhe nuk janë vetëm", ka theksuar kryeministri Haradinaj, duke shtuar se nga Ferronikeli do ta dërgojnë porosinë për të gjithë investitorët e tjerë potencialë që të investojnë në vendin tonë.

Drejtori i Balfin Group, që tash ka në pronësi kompaninë "NewCo Ferronikeli", Samir Mane, e ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për vizitën e sotme, ku e ka njoftuar nga afër me ambientin, prodhimin në Ferronikel, si një nga fabrikat më të rëndësishme për Kosovën, po ashtu edhe për ecurinë e këtyre muajve prej se e kanë marrë fabrikën në pronësi. "Po ashtu, diskutuam edhe planet për të ardhmen për një bashkëpunim më të madh si me qeverinë lokale, por edhe atë qendrore", ka thënë Mane.

Më pas kryeministri Haradinaj, i shoqëruar nga presidenti i Grupit Balfin, Samir Mane, dhe kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka vizituar Departamentin e Prodhimit, ku ka prëa nga afër procesin e prodhimit dhe nga përfaqësuesit është njoftuar me procesin e punës dhe përpunimit të metalit në këtë fabrikë. Kryeministri Haradinaj ka vizituar edhe mensën e Ferronikelit, në të cilën ka drekuar bashkë me punëtorët e kësaj fabrike.

# Kosova, adresë e besueshme për investime amerikane

PRISHTINË, 21 JANAR (ER) - "Me rritjen ekonomike më të madhe në rajon, zvogëlimin e tarifave tatimore, reformat thelbësore në sundim të ligjit dhe ato fiskale, si dhe me ligjin për investime strategjike, Kosova ka hyrë në hartën e vendeve atraktive dhe të sigurta për investitorët e huaj", ka thënë kryeministri Haradinaj të hënën gjatë takimit me delegacionin amerikan, të përbërë nga Daniel Cannon, Ryan Zinke, dhe Steven Lindgren, përfaqësues të Artillery One. Kryeministri Haradinaj ka bërë me dije se në këtë takim kanë folur për mundësitë e shumta për investime në sektorin e ujërave, teknologjisë dhe të telekomunikacionit në vendin tonë. "Pas investimit të Contour Global në energji dhe me krijimin e Zonës së Veçantë Ekonomike Amerikane në Gjakovë, Kosova tashmë është adresë e besueshme për investime amerikane", ka thënë Haradinaj.



# Shënohet 50-vjetori i themelimit të arkivit Komunal të Prishtinës

PRISHTINË, 21 JANAR (ER) - Komuna e Prishtinës ka shënuar 50-vjetorin e themelimit të arkivit Komunal të Prishtinës. Kjo komunë ka bërë me dije se ky arkiv vazhdon t'u shërbejë kryeqytetasve për materiale të ndryshme. "Si sot, 50 vjet më parë, u themelua Arkivi Komunal i Prishtinës i cili vazhdon t'u shërbejë mijëra qytetarëve me materiale gjatë vitit. Arkivi Komunal i Prishtinës është një ndër arkivat më të mëdha në Kosovë, me fond shumë të madh të koleksioneve arkivore, përfshirë vendime të organeve komunale, të gjykatave, dokumenteve të arsimit, ekonomisë, kulturës, shëndetësisë e të ngjashme", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.





# Komuna e Mitrovicës inkasoi mbi 92 për qind të hyrat vetjake

MITROVICË, 21 JANAR (ER) - Drejtuar nga nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, të hënën është mbajtur mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve, në të cilën janë diskutuar dhe shqyrtuar çështje të rëndësishme nga fushëveprimi i bordit dhe drejtorive komunale. Në mbledhjen e këtij bordi përfaqësuesja nga UN-Habitat, Zana Sokoli, ka prezantuar Planin Zhvillimor Komunal për vitin 2009-2025, me ç'rast ka falënderuar drejtorët komunalë për bashkëpunimin e mirëfilltë të tyre dhe anëtarëve të grupeve punuese për hartimin e këtij plani. Po ashtu, pjesë e Planit Zhvillimor Komunal të Mitrovicës është edhe kompania konsulente "INSI" sh.p.k e cila bën hartimin e këtij plani. Ndërsa drejtori i Urbanizmit, Besnik Beka, ka thënë se është tejet mirënjohës për bashkëpunimin e mirë që ka pasur ndër vite Komuna e Mitrovicës me UN-Habitat dhe kompaninë në fjalë. Ai ka theksuar se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe më tutje. Në anën tjetër, drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Tafil Peci, ka kërkuar nga Bordi i Drejtorëve që të formohet një komision ku do të shqyrtohet mundësia për krijimin e një rregulloreje për dhënien e dekoratave të ndryshme. Kurse drejtori për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, Shukri Gashi, ka njoftuar bordin lidhur me inkasimin e të hyrave vetjake për vitin 2018, duke thënë se përgjatë këtij viti inaksimi i këtyre të hyrave ka qenë 92.17 për qind.

# Së shpejti pritet të ndërtohet spitali rajonal në Skenderaj

SKENDERAJ, 21 JANAR (ER) - Një delegacion nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka vizituar Komunën e Skenderajt, ku ka premtuar ndërtimin e një spitali rajonal në këtë komunë. Kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, ka thënë se komuna që ai drejton është e interesuar për të gjithë partnerët që investojnë në Skenderaj. "Çdo ditë e më tepër po shtojmë përpjekjet dhe hapat për realizimin e projektit më madhor që Skenderaj ka pasur ndonjëherë - Penda e Drenicës, një projekt dhjetëra miliona euro, i cili do ta zgjidhë përfundimisht problemin e ujit të pijshëm për së paku 200 mijë banorë. Vizita e mikut tim nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Daniel Cannon, një njeri i zot në financa ndërkombëtare, dhe bankier i dalluar investiv, është ekskluzivisht rikonfirmim i premtimit të tij për investim në dy projekte tejet të rëndësishme: Penda e Drenicës dhe ndërtimi i një spitali rajonal", ka thënë Jashari. Ndërsa përfaqësuesi i delegacionit amerikan, Daniel Canonn, ka deklaruar se arsyeja e vizitës së tyre është që ta përmbushin premtimin e dhënë që të ndërtojnë një spital në Skenderaj.




# Studentët nga Iowa vizitojnë Vushtrrinë



VUSHTRRI, 21 JANAR (ER) - Njëzetë e pesë (25) studentë nga Iowa kanë vizituar të hënën qytetin e Vushtrrisë. Kryetari i komunës, Xhafer Tahiri, ka bërë me dije se studentët i ka njoftuar me qytetin e Vushtrrisë, kulturën e historinë e pasur, mbi të gjitha me njerëzit e mirë të saj. "Miqësia dhe bashkëpunimi ynë me Iowan po jep rezultate konkrete në këmbimet kulturore dhe ekonomike", ka thënë kryetari Tahiri.

# Ndërron jetë Hajrë Gashi, mjeshtri i armëve të UÇK-së



SKENDERAJ, 21 JANAR (ER) - Ka ndërruar jetë të hënën veterani i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hajrë Gashi nga Komuna e Skenderajt. Gashi ishte kthyer nga Gjermania së bashku me djemtë e vet për t'iu bashkuar radhëve të UÇK-së. Baca Hajrë gjatë luftës në shtëpinë e vet në Rezallë të Re kishte prodhuar topin pa dridhje dhe minahedhësin për luftëtarët e UÇK-së, së bashku me Bekim Berishën-Abenë.

# Doni të bëni këmbim territoresh? Atëherë bëjeni sipas kufijve kadastralë të komunave!



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

**Në situatë normale, as korrigjim të kufijve e as këmbim të territoreve:** Po të kishim politikanë me shkollë fillore të përgatitjes politike nuk do të vinim në situatë që, 20 vjet pas përfundimit të luftës dhe 11 vjet pas shpalljes së pavarësisë, të bisedojmë me Serbinë për kufijtë e Kosovës dhe statusin e saj politik dhe juridik. Por, meqë kemi politikanë të fortë në muskuj të gjymtyrëve e që u mungojnë muskujt në koqe, e sidomos muskuli i unazës së prapanicës (prandaj u zgjerohet lehtë dhe shpejt), po bisedojmë për të gjitha që i përshtaten Serbisë duke e kthyer Serbinë në skenë, pasi ajo ishte përjashtuar në qershor të vitit 1999. Kufijtë e të gjitha ish-republikave të ish-Jugosllavisë ishin përcaktuar dhe nuk u ndryshuan edhe pasi u bënë shtete të pavarura dhe sovrane, pas një lufte të imponuar nga Serbia e Milloshevigit, ku rol kishte edhe Milloshevigi i sotëm i Serbisë, presidenti Aleksandar Vuçiq. Me Maqedoninë Veriore u ndamë të lagur rreth Debëlldesë dhe për pronarët e tokave, shtetas të Kosovës e që u bënë pjesë e këtij shteti, u siguruan lejet që, kur të duan mund t'i vizitojnë pronat e tyre si dhe, për një kohë edhe do të mund të punojnë në to, sipas modelit që e përdor Izraeli ndaj palestinezëve e që i kanë pushtuar pronat e palestinezëve. Mali i Zi u tregua bashkëpunues derisa i vendosi kufijtë brenda territorit që e kishte paraparë 100 vjet e më parë "eksperti" për kadastër i quajtur Knjaz Nikolla i cili, si njësi matëse për shënjimin e kufirit përdori topa, shpata, kama, pushkë, singija, bomba dhe granata pas të cilave pjesa e madhe e banuar me shqiptarë autoktonë u pastrua nga shqiptarët duke i shpërngulur me dhunë apo duke i shndërruar ato toka në varreza masive për shqiptarët e ekzekutuar dhe të torturuar. Gjakun e shqiptarëve dhe krimet e Knjaz Nikollës, Mali i Zi i përdori si tapi apo fletë poseduese për bartjen e pronësisë nga toka shqiptare në tokë të Malit të Zi.

Hashim Thaçi është lojtar i madh kur luan me injorantët, të pakurrizorët, me ata që nuk e duan dhe nuk e dinë çka është atdheu dhe patriotizmi sepse, në mungesë të traditës familjare, nuk kanë qenë në gjendje ta ndërtojnë as traditën personale. Përveçse janë të pafytyrë, ata nuk kanë as identitet njerëzor, kombëtar dhe moral. Si rrethanë lehtësuese e kanë trashëgiminë familjare apo ADN-në (nëse më lejohet ta citoj eksperten e madhe ndërkombëtare për gjenetikë, juristen dhe politikanen Vjosa Osmani). Hashimi është lojtar i madh i prapaskenave dhe goditjeve nën brez. Madje është edhe më i shquar për ngulitje që ua bënë, kryesisht prapa shpine, ku është edhe vendi i veçantë për ngulitje! Ngulitja, si proces, është tejet komplekse dhe duhet të plotësohen disa parakushte si do të cilësohet: e pabesë, e vullnetshme, dashamirëse, fekonduese, e pritshme, e dëshirueshme, e porositur apo befasuese. Askush në Kosovë nuk përmend lojën me kufij me Serbinë përveç Shkurte Fejzës dhe Hashim Thaçit. Shkurte Fejza, në baza ekskluzivisht patriotike dhe jo materiale, e këndonte këngën për bashkimin e Mitrovicës së ndarë dhe të cilin bashkim me aq mençuri, vendosmëri, patriotizëm dhe sigurisht që nuk e përjashton as sakrificën më sublime po e bën Agim Bahtiri, mik i Shakirës së Kolumbisë, vendlindje e Eskobarit e që, për dallim nga Kosova, ka përfituar në procesin e liberalizimit të vizave. Po edhe Agim Bahtiri ka diçka kolumbiane apo eskobariane, shikimin e mprehtë dhe plot inteligjencë dhe pasionin për zgjerim të territorit. Edhe flokët i ka bërë pis të zeza, si kolumbian i vërtetë dhe i mungojnë vetëm mustaqet për t'u bërë latino-amerikan i vërtetë. Zërin e ka pushkallë sikur që është edhe ashik i madh. Po ku mbeti Hashim Thaçi në këtë mes? As të kërthiza e Agim Bahtirit dhe te fundi i fustanellës së punuar me vek të Shkurte Fejzës! Hashim Thaçi kohën e fundit po flet vetëm për marrëveshje me Serbinë dhe Vuçiqin. Për korrigjim të kufijve dhe për ndërrim të territoreve. Kësaj teme i është kapur si i trenti kosit, siç thonë! Flet për një marrëveshje obligative me Serbinë pas së cilës do të siguronim një vend në OKB, do të bëheshim pjesë e BE-së dhe NATO-s. Hashimit duhet t'i besohet sepse edhe në procesin e liberalizimit të vizave ia ka "qëlluar" 100 për qind. Hashimi po flet për normalizim të marrëdhënieve me Vuçiqin dhe Serbinë në kohën kur nuk ka asnjë marrëdhënie normale me asnjë shqiptar përveç kotillës politike që i shërben, Edi Ramës dhe Baton Haxhiut. Nëse nuk e heq taksën 100 për qind për mallrat serbe, ka rrezik të madh që do ta humbë besimin edhe te Ivica Daçiqi dhe përkthyesës së "malli Sllobës" apo Sllobës së Vogël, Daçiqit të cilën e donte dhe e respektonte më shumë se vet Edita Tahirin! Nëse e analizoni kotillën politike dhe përkrahëse të Hashim Thaçit që e shalon një kohë të gjatë, në mesin e tyre nuk mund ta gjeni edhe as një të vetëm që ka të kaluar kombëtare, kurse moralen e kuptojnë në trajtën që është 100 për qind e kundërt me vlerat morale! Tash këta njerëz mendoni se do të punojnë për interes të shtetit dhe kombit?!!! Kur kurrë nuk kanë pasur, as komb e as atdhe! Apo i kanë shërbyer një atdheu apo kombi tjetër. Ose për faktin se, kombin dhe atdheun e identifikojnë me madhësinë e foteles së përmasave të prapanicës së tyre si dhe shumës në xhirollogari. Hashimi është mjeshtër i ndryshimit të roleve apo karaktereve! Karaktereve!!! E keni parë se me sa entuziazëm e ka pritur formimin e Ekipit Negociator. Madje, një herë është takuar me bashkëkryesuesit dhe, së fundi ka premtuar, meqë Ekipi Negociator sa serioz që është ka kërkuar letra apo diçka të shkruar në letër, së voni ka premtuar se do t'u dorëzojë ca letra... të tualetit ku do të shiheshin informatat e kërkuara, mbase vetëm gjurmë apo stampim i relievit të prapanicës së kryenegociatorit! Hashimi po luan fort gogla me ta, ashtu siç e meritojnë shkaku se e kanë pranuar një rol të tillë!

Personalisht jam fuqishëm kundër ndryshimit të kufijve me Serbinë, në çfarëdo forme. As me ia dhënë një milimetër tokë e as me ia marrë (nuk kemi kaçik për këtë) edhe një milimetër. Këtë na pamundëson edhe Kushtetuta e Ahtisar Kosovës. Tash, Hashim Thaçi po deklaron se e marrim Luginën e Preshevës dhe nuk japim asgjë, gjë që edhe optimisti më i madh, me të meta të theksuara mendore, nuk e beson. Disa shqiptarë të Luginës së Preshevës e që Luginën e kujtojnë vetëm nga gojëdhënat, apo e kanë dëgjuar si term gjeografik, kanë filluar t'i besojnë këtij premtimi. Ndërsa vetë Hashimi dhe disa të kotillës politike të Hashimit, në përpjekje ta mbrojnë Hashimin, të gjithë atyre që nuk besojnë në këto premtime fatamorganike të Hashimit, i diskualifikojnë duke iu thënë se a jeni kundër bashkimit të Luginës së Preshevës a? Jam kundër ndryshimit të kufijve sepse do të ndahemi të lagur dhe stërlagur. Historikisht, me lojërat pa kufij, shqiptarët gjithmonë kanë humbur! Mirëpo kjo nuk më pengon të dëgjoj mendime të ndryshme edhe kur nuk pajtohem me to. Një mik imi shumë i mirë që më la pjesën e ëmbëlsirës që nuk e hëngri për faktin se nuk i pëlqeu, më dha një propozim për ndryshimin e kufijve dhe ndërrim të territorit me kusht që t'i kthehen 250 hektarë mal të mbetur në Serbi. Nuk i kërciti palla, as për Trepçën apo Ujmanin! Një tjetër tha se i duhet një territor kah anamorava dhe Karadaku për ta zgjeruar korridorin e kontrabandës me Serbinë e që e zbërthente si bashkëpunim ndërkufitar e që përkrahet shumë edhe nga shtetet e BE-së. Propozimi i tretë m'u duk më serioz dhe më bindës; miku im propozoi që tri komunat e luginës së Preshevës (Medvegja, Bujanoci dhe Presheva) të këmbehen me komunat e veriut (Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveqani) të këmbehen në kufijtë ekzistues kadastralë dhe të cilën Serbia kurrë nuk do ta pranonte. Kur ia futëm lapsin + dëshirat, filloi të më bëhet e pranueshme me kusht që Mitrovica të bashkohet, me kryetar Agim Bahtirin dhe askënd tjetër dhe se për Gazivodën dhe Trepçën të mos bisedohet fare. Kështu do të ruhej karakteri shumetnik i Kosovës, kurse Serbia do të spastrohej nga shqiptarët. Mendoj se gjërat do të zhvillohen ndryshe: në këmbim të disa xhamive të Luginës ose ndonjë qendër për kultivim të marijuanës dhe heroinës, shqiptarët e kosovarizuar, me Hashim Xhingis Kanin do të japin territor cilësor. Tash edhe Hashimi po thotë se këtë plan e përkrahin BE-ja dhe Amerika në kohën kur në Amerikë presidenti Tramp po hetohet për afrim të madh me Rusinë dhe Putinin, në dëm të ShBA-së dhe që Hashim Thaçi po thotë se e ka edhe përkrahjen e Putinit. Krejt është ngatërruar leshi! Ndërkombëtarët nuk i kundërshtojnë deklarimet e Hashim Thaçit sepse po përputhet me projektin e tyre.

**Kush e kundërshton Hashimin është kundër Amerikës dhe BE-së:** Më parë, kur na fusnin në burg dhe na dënonin sikur edhe kur diferenconin familjet tona, thoshin se kush është për liri dhe pavarësi të Kosovës është kundër vëllazërimbashkimit, kundër Titos dhe Jugosllavisë, kundër Stambolliqit dhe Serbisë, kundër Rrahman Morinës, Azem Vllasit dhe Kosova dhe Metohisë etj. Tash, nëse jemi kundër ndryshimit të kufijve, na akuzojnë se jemi kundër BE-së dhe Amerikës, Hanit dhe Trampit, Mogerinit dhe Salvinit, Aleksandar Vuçiqit dhe Ivica Daçiqit, me një fjalë nuk na kanë lënë derë për ta hapur duke na privuar nga miq dhe armiq! Merreni me mend, alamet burra që kanë qenë në burgje dhe që kanë luftuar, tash dridhen si miu para maçokut, para një letre të Trampit, para fustanit të Mogerinit dhe shallvareve të Johanes Hanit, të prodhuara në Pozharevc të Serbisë! Taksa prej 100 për qind për mallrat nga Serbia dhe Bosnja ka qenë veprimi më i butë që ka ndërmarrë Kosova ndaj Serbisë. Dhe si të tillë po na detyrojnë ta pezullojmë. Politikanët tanë "pragmatikë" kanë filluar të kërkojnë një zgjidhje prej Sollomoni, ta pezullojnë taksën dhe ta ruajnë prapanicën duke e mbuluar me flamur të bardhë që diku konsiderohet si simbol i paqes e diku si simbol i dorëzimit! Kryeministrin Haradinaj po e kërcënojnë se do t'ia presë kokën politike nëse e kundërshton pezullimin e taksës sepse, përveç Serbisë, këtë po e kërkojnë miqtë ndërkombëtarë! Hashim Thaçi po i ngutet për marrëveshje dhe atij nuk i konvenojnë zgjedhje të reja përveç se, ose Ramushi të bëhet Hashim, ose që të formohet një qeveri tjetër, pa Ramushin kryeministër. Nuk janë aspak të rastësishme të gjitha këto greva pikërisht në kohën kur po flitet për një marrëveshje idiotike me Serbinë, e quajtur marrëveshje historike. Nuk është taksa 100 për qind siguri për Ramushin se do të mbetet në pushtet sikur që nuk është pezullimi i kësaj takse biletë hyrëse te ndërkombëtarët, pa u pastruar me të kaluarën! Nuk është e rastit edhe shtimi i punës i Gjykatës Speciale që po thërret aq shumë dëshmitarë të dyshuar pikërisht në këtë kohë. Qofsha i gabuar në këto parashikime!

**Vjosa Osmani, Maria Kiri e ADN-së dhe gjenetikës:** Vjosa Osmane, juriste dhe deputete e LDK-së, njihet si eksperte për çështje kushtetuese! I ka humbur të gjitha rastet para Gjykatës Kushtetuese, gjysma e të cilave nuk kanë njohuri elementare për çështje gjyqësore. Së fundi, për ta sulmuar pozitën, përkatësisht PDK-në apo kryetarin e saj, Kadri Veseli i cili, në një intervistë tha se Isa Mustafën nuk e ka rrëzuar PDK-ja, por deputetët e LDK-së duke përmendur Vjosa Osmanin dhe Anton Qunin, që edhe është e vërtetë. Në fund të fundit, këta as që e kanë votuar Isa Mustafën për kryeministër dhe në këtë kontekst më të ndershëm kanë qenë deputetët e PDK-së që e kanë votuar Isën se nja 10 deputetë të LDK-së që nuk e kanë votuar propozimin e Isës dhe të cilët Isa i pati anatemuar publikisht, sikur ajatollahët e Iranit që e anatemuan shkrimtarin Salman Ruzhdi. Si përgjigje ndaj deklaratës së Kadri Veselit, Vjosa Osmani tha se PDK-ja e ka ADN-në e tradhtisë dhe të mashtrimit në gjenet e saj, duke injoruar faktin se, tradhtia sikur edhe mashtrimi nuk trashëgohen, por fitohen më vonë. Gjenetika dhe ADN-ja nuk e përcaktojnë se kush do të bëhet mashtrues, tradhtar, hajdut, politikan, i keq apo i mirë por se, nëpërmjet gjeneve kushtëzohen disa veçori fizike dhe shëndetësore. Embrioni nuk ngjizet me gjak, por me spermatozoid dhe në bazë të kësaj përcaktohet më vonë struktura gjenetike. Jo se PDK-ja është ndonjë parti në emër të së cilës duhet të bësh be dhe rrufe për ndershmëri dhe besë mirëpo, LDK-ja, e ngjizur nga koqet politike, njerëzore, kombëtare dhe morale të Rrahman Morinës, si trashëgimtare e Lidhjes Socialiste të Popullit Punonjës të Jugosllavisë, si dhurues i spermës politike dhe programore, kombëtare dhe morale, do të duhej të ishte partia e fundit që të mbajë ligjëratа për besë dhe ndershmëri! Pastaj, përpjekjet për ta mbrojtur Kadri Veselin nga një diversion diletant gjenetik i Vjosa Osmanit, të disa tereqëve dhe tarakeshave të PDK-së e degraduan krejtësisht mbrojtjen deri në neveri! Edhe këta "mbrojtës", duke e huqur temën e mbrojtjes, u barazuan me Vjosa Osmanin, vetëm në një terren tjetër! Mustafa Nano kohë më parë pati deklaruar se shumica e shqiptarëve janë serbë, jo se kanë bërë transfuzion të gjakut, por se janë shkërdhyer nga serbët dhe për këtë qenka përzier gjaku! Ilustrim shumë i ulët, por me këtë hiqet dilema se a më e vjetër është pula (sperma) apo veja (gjaku). Për ata që e duan gjenetikën dhe ADN-në!

## Një afroamerikane demokrate kandidate për presidente të ShBA-së



UASHINGTON, 21 JANAR - Kamala Harris, senatore nga Kalifornia, me profesion juriste, e cila ka shërbyer si prokurore e përgjithshme e shtetit të Kalifornisë, njihet për pyetjet e forta drejtuar kandidatëve të presidentit Trump për poste kabineti. Tani ajo do të njihet edhe si kandidate presidenciale. Senatorja shpalli të hënën synimet për të garuar në zgjedhjet presidenciale të 2020-s. Ajo u zotua "t'i bashkojë të gjithë zërat tanë" si platformë elektorale. Nëse fiton, Harris do të bëhej e para grua presidente e ShBA-së dhe, pas Barak Obamës, e dyta e përkatësisë racore afrikano-amerikane që shërben në postin më të lartë ekzekutiv në ShBA dhe rolin më të fuqishëm në botë.
Harris, bijë e imigrantëve të vendosur në Okland të Kalifornisë, është një ndër pretendentët e hershëm demokratë që shpallin synimet për të garuar. Pritet që një numër i madh pretendentësh ta shpallin kandidaturën në muajt në vazhdim.
54 vjecja Kamala Harris e prezantoi veten si një kandidate e dedikuar për drejtësi, dinjitet dhe barazi në një video të publikuar nga fushata e saj. "Këto janë vlerat që kemi të shtrenjta ne si amerikanë dhe këto vlera janë të rrezikuara aktualisht. Brezi i ardhshëm i ka varur shpresat tek ju dhe miliona të tjerë që t'i bashkojmë zërat për të luftuar për vlerat amerikane", tha ajo.
Senatoret Elizabeth Warren nga Masaçusets dhe Kirsten Gillibrand nga Nju Jorku kanë shpallur synimet për të garuar. Senatori Cory Booker nga Nju Xhërsi, Sherrod Brown nga Ohajo dhe Amy Klobuchar nga Minesota mendohet se do të futen së shpejti në garë.

# 51 vjet pas vrasjes së Martin Luther Kingut

Dr. Martin Luther King, Jr., predikuesi afrikano-amerikan udhëhoqi një lëvizje të të drejtave civile që ndryshoi Amerikën dhe bëri jehonë në mbarë botën. Qysh atëherë, Amerika ka bërë hapa të mëdhenj në çështjen racore, por ndarjet e thella ende vazhdojnë



UASHINGTON, 21 JANAR - Kanë kaluar 51 vjet që nga vrasja e Dr. Martin Luther Kingut, Jr. - predikuesi afrikano-amerikan i cili udhëhoqi një lëvizje të të drejtave civile që ndryshoi Amerikën dhe bëri jehonë në mbarë botën. Qysh atëherë, Amerika ka bërë hapa të mëdhenj në çështjen racore, por ndarjet e thella ende vazhdojnë.
29 gusht 1963... ishte një fjalim që elektrizoi kombin dhe i vendosi të drejtat civile dhe drejtësinë ekonomike në qendër të debateve në Amerikë. "Ajo që ai po përpiqej të arrinte ishte barazia racore dhe jo vetëm barazia racore, por edhe drejtësia ekonomike. Ne e dimë se pikërisht përpara se të vdiste, ai po punonte në Fushatën për Njerëzit e Varfër. Ai ishte në Memfis duke punuar me punëtorët sanitarë, të cilët ishin në grevë dhe në thelb po kërkonin vetëm një pagë për të jetuar", tha profesoresha për Racën, Median dhe Komunikimin në Universitetin Amerikan, Sherri Williams.
Greg Carr në Universitetin Howard thotë se ndërsa ka pasur përparim, pabarazitë ekonomike ende ekzistojnë. "Nëse shikoni Amerikën me ngjyrë në përgjithësi, ekonomikisht një familje afrikano-amerikane në këtë vend, ka një pasuri prej 10 centësh për çdo dollar që ka një familje e bardhë. Pra, një të dhjetën e pasurisë së një familjeje të bardhë - kjo është absurde", tha ai.
Por ekonomia e tanishme relativisht e fortë amerikane, ka gjallëruar tregun e punës për të gjitha racat. Shkalla e papunësisë për afrikano-amerikanët ra nën 6 për qind vitin e kaluar, më e ulëta që nga viti 1972. Megjithatë, sipas një studimi të fundit nga Universiteti i Harvardit, gjysma e të gjithë amerikanëve me ngjyrë njoftuan diskriminim në vendin e punës.
Yonas Beshawred është inxhinier informatike në Silicon Valley. Ai thotë se si një imigrant afrikan ai përballet me të njëjtin lloj diskriminimi si afrikano-amerikanët. "Ndodh në mënyra të ndryshme, p. sh., kur shkon në një takim me një investitor, kupton se ata thjesht nuk duan të dëgjojnë atë që ke për t'u thënë. Ndoshta është sipërmarrja jote. Ndoshta është si ajo për të cilën po punon, por herë pas here e ndien se është vetëm për shkakun tënd dhe të ngjyrës tënde. Ata thjesht nuk duan të kenë të bëjnë me njerëzit me ngjyrë dhe unë vetëm e anashkaloj këtë fakt. Them me vete, 'nuk është për mua, do të shoh për një mundësi tjetër'", tha ai.
Brutaliteti i policisë në shumicën e komuniteteve afrikano-amerikane është një tjetër shqetësim. Lëvizja "Black Lives Matter", që u shfaq në vitin 2014, e mori vrullin pas vrasjes së një afrikano-amerikani në shtetin e Missourit nga një oficer policie i bardhë. "Na ka ndihmuar ne, njerëzit me ngjyrë, të kuptojmë se ndërsa mund të mos shihemi si njerëz, apo të fuqishëm tani për tani, frytet e punës sonë do të vijnë së shpejti", thotë Dennis Rodriguez, përkrahës i lëvizjes "Black Lives Matter".
Të jesh një njeri me ngjyrë në Amerikë ka ndryshuar që nga fjalimi i famshëm i Martin Luther King "Kam një ëndërr". Amerika votoi dy herë një president afrikano-amerikan në vitin 2008 dhe përsëri në vitin 2012, por përmirësimi i marrëdhënieve racore - siç dëshmohet nga një ringjallje kohët e fundit e grupeve të supremacistëve të bardhë - është ende larg.

## Papa prezanton aplikacionin e lutjes



VATIKAN, 21 JANAR - Papa Françesku i bëri jehonë një aplikacioni digjital që u mundëson besimtarëve të luten me të, të quajtur "kliko për t'u lutur", përpara Ditës Botërore të Rinisë 2019 që mbahet në Panama prej datës 22 deri më 27 janar. Vatikani ka futur një shërbim të ri në faqen e vet të internetit që, siç thuhet, do t'u japë mundësi besimtarëve "të shoqërojnë Papën në një mision humanitar për botën".
Të rinjtë nga e gjithë bota u mblodhën në Bazilikën e Engjëjve në Kosta Rika të dielën përpara udhëtimit për në Panama për Ditën Botërore të Rinisë që mbahet në Amerikën Qendrore. "Jemi shumë dhe është shumë mirë të takohesh me të gjithë", thotë Macarena Cors, pelegrin meksikan.
Të paktën 2.5 milionë veta morën pjesë në Ditën Botërore të Rinisë në Krakovë të Polonisë, por ngjarja u errësua nga protestat lidhur me raportet që dëshmojnë se Vatikani ka mbuluar abuzimet seksuale të priftërinjve katolikë. Gjatë fjalimit të tij të së dielës për dhjetëra mija veta në Sheshin e "Shën Pjetrit", Papa bëri thirrje për lutje për suksesin e Ditës Botërore të Rinisë në Panama.

Fjalim i mbajtur në Akademinë Përkujtimore në Gjilan, në njëvjetorin e ndarjes nga jeta, të Liderit të Luginës së Preshevës Jonuz Musliu

# JONUZ MUSLIU PERSONALITET I MADH I KOMBIT




Ismet SYLEJMANI

*E nderuar familje e Jonuz Musliut!*
*Të dashura familje të deshmorëve!*
*Shokë e bashkëveprimtarë të Jonuzit!*
*Ish të burgosur politik!*
*Ushtarë e komandantë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!*
*Ushtarë e komandantë të Ushtrisë për Preshevë, Medvegjë e Bujanovc!*
*Përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale!*
*I nderuar nënkryetar i Komunës së Gjilanit!*
*I nderuar Kryetar i Kuvendit Komunal të Bujanovcit!*
*Kryetar i Lëvizjes për Progres Demokratik, djali i Jonuzit, Shqiprim Musliu!*

Po bëhet një vit pa Jonuzin! Vdekja e morri atëherë kur ai më së shumti i duheshte Luginës së Preshevës!

Jonuz Musliu, sikur e kemi thënë në të kaluarën, që kur i mbylli sytë përgjithmonë, po dëshmohet se ka qenë një figurë dhe personalitet i madh, vlera e të cilit gjithnjë e më shumë po shkon duke u rritur dhe duke u shpërfaqur.

Lugina e Preshevës ka mbetur pa liderin e sajë dhe shpresojmë që fryma e tijë, puna e tijë, ta shoqërojë çdo figurë e çdo udhëheqës të asaj pjese të Atdheut që na ka mbetur jashtë aureolës tonë të kombit.

E ardhmja po dëshmon se njerëzit dhe figurat e mëdha sikur Jonuzi, Atdheut i japin edhe atëherë kur zemra nuk ju rrahë më.

Përvjetorët për Jonuzin, ky pervjetor i parë po dëshmon se kanë për tu shëndrruar në një uragan ku gjeneratat e reja mësojnë nga bashkëveprimtarët, nga bashkëdrejtuesit që kanë jetuar në kohën e Tijë.

Sa më shumë të nderojmë njeriun që edhe pas luftës së Ushtrisë për Presheve, Medvegjë dhe Bujanoc nuk i kthej krahët nga ajo pjesë e Atdheut, sepse Ai u dëshmua që është birë besnik, që luftën e vazhdon edhe në forma dhe variante e kushte tjera!

Serbia pushtuese me Jonuz Musliun udhëheqës të Luginës së Preshevës e ka pasur padyshim më vështirë, por nuk do ta ketë më lehtë edhe sot, sepse Jonuzi po e dëshmon praktika, se ka e do të ketë vazhdues të denjë, të cilët rrugën e Tijë jo vetëm që nuk do ta braktisin, por do ta ecin e do ta ushqejnë me dashuri e besnikri të pafund!

Lavdi e përjetshme jetës dhe veprës së Jonuzit!
Lavdi dëshmorëve të Atdheut!

**Gjilan, më 20 Janar 2019!**





E rrallë

## Gjendet në Izrael thesari 900-vjeçar



Një thesar i përbërë nga 24 monedha ari të çmuar dhe një vëthë i të njëjtit material u gjet në një vend arkeologjik të Parkut Kombëtar të Cezaresë, një qytet i lashtë i mbretërisë së Judesë. Gjetjet, të identifikuara brenda një vazoje të vogël të fshehur midis dy gurëve të një muri, datojnë që nga fundi i shekullit të njëmbëdhjetë, një periudhë që përkon me pushtimin e përgjakshëm të qytetit gjatë kryqëzatave.

FOTO E DITES



Pjesëmarrësit konkurrojnë në garën e shtatë vjetore të vaskave. Rreth 100 ekipe morën pjesë në këtë ngjarje që u mbajt në Stoos të Zvicrës. /Barcroft Images/

E jashtëzakonshme

## Hoteli i parë hapësinor luksoz




Hoteli i parë hapësinor në botë, "Aurora Station", u zbulua javën që lamë pas për herë të parë. Mysafirët e parë "Aurora Station" do t'i mirëpresë në vitin 2021. Ky hotel hapësinor luksoz do të ketë vend për gjashtë veta, duke përfshirë dy anëtarë të ekuipazhit për udhëtime hapësinore dymbëdhjetëditore.

## BARSOLETA E DITËS



**Kthehet djali prej shkolle dhe e pyet i ati:**
**- A e përmirësove atë njësh në matematikë, bir?**
**- Jo baba, se është e shkruar me laps kimik.**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Në ora 16:00

### "THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney







Në ora 17:30

### "THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

### "MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers







Në ora 22:00

### "HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Gjithçka që nuk ka ecur sipas planeve tuaja sot mund të rivlerësohet nëse paraqitet një situatë e re.



**DEMI**
Me kalimin e Hënës në shenjë ju do të bëheni shumë të dashur me njerëzit që ju rrethojnë dhe partnerin. Nuk do të ndaleni në surpriza sot.



**BINJAKËT**
Pozitiviteti dhe energjitë e mira sot do të superojnë ato çasti dyshimi që do t'ju kaplojnë gjatë ditës. E rëndësishme është të ndiheni mirë.



**GAFORRJA**
Një ekuilibër perfekt midis dashurisë dhe karrierës sot do të bëjë që ju të jeni epiqendra e shumë situatave interesante.



**LUANI**
Sot duhet t'ia dilni mbanë vetë një problemi që mund të lindë në punë. Edhe pse jeni dyshues në aftësitë tuaja, do të keni përfundime të shkëlqyera.



**VIRGJËRESHA**
Ndiheni disi të zhgënjyer nga partneri sot sepse nuk ka të njëjtin përkushtim si ju në lidhje. Mbase ngaqë karakteret tuaja ndryshojnë.



**PESHORJA**
Sot dita paraqitet shumë e këndshme saqë në çaste të caktuara do t'ju duket sikur keni ikur përsëri me pushime.



**AKREPI**
Sot do të mbizotërojë ndjenja e xhelozisë në ditën tuaj. Edhe për situatë shumë të pafajshme do ta bëni fajtor partnerin.



**SHIGJETARI**
E keni nisur ditën me shumë vrull dhe po kështu do ta përfundoni. Keni energji pa fund dhe iniciativat e reja që keni ndërmarrë po ju pëlqejnë.



**BRICJAPI**
Sot duhet të jeni më konkret në planet dhe punët tuaja. Shumë mendime nuk po arrini t'i konkretizoni në praktikë.



**UJORI**
Çdo gjë shkon mirë me partnerin dhe miqtë tuaj, por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për financat. Po ndjeni që keni nevojë për disa të ardhura mujore më tepër.



**PESHQIT**
Do të merrni një mesazh mjaft të qartë nga personi për të cilin po mendoni kohët e fundit. Pritet një dashuri e re në horizont.

# Naomi Campbell në lidhje me këngëtarin 23 vjet më të ri, Liam Payne



Supermodeluesja Naomi Campbell dhe këngëtari Liam Payne kanë ndezur thashethemet se janë në një romancë. Mediat kanë aluduar për një lidhje mes tyre për shkak të komenteve që Naomi dhe Liam kanë lënë në fotot e njëri-tjetrit. Këngëtari dhe modeluesja 23 vjet më e madhe flirtuan shumë publikisht në "Instagram". 48-vjeçarja publikoi një selfie dhe Liam shfrytëzoi momentin për ta komplimentuar.



# Brad Pitti në lidhje me aktoren e famshme?

"The Sun", një prej tabloidëve më të rëndësishëm të Britanisë së Madhe, ka dhënë lajmin për çiftin më të ri në botën e shoubizit. Brad Pitti dhe Charlize Theroni janë dashuruar. Çifti, sipas së përditshmes, frekuentohet prej më pak se një muaji dhe për momentin do të donin që lidhjen e tyre ta mbajnë në një profil të ulët, pa përfshirë fëmijët respektivë. "Njihen prej pak kohësh", ka raportuar "The Sun".

# Maisie Williams me stil të veçantë



Aktorja Maisie Williams është komentuar shpeshherë për stilin e veçantë të veshjeve. Ajo së fundi mori pjesë në Javën e Modës në Paris dhe aty pati një paraqitje të mrekullueshme. Williamsi pati të veshur një fustan interesant dhe e shoqëronte atë me një çantë ngjyrë rozë.



# Pogba, një ikonë mode së bashku me mamanë e vet

Marka e veshjeve sportive "Adidas" ka lansuar reklamën më të fundit. Pjesë e spotit të radhës kanë qenë dy yjet e Manchester Unitedit, Paul Pogba dhe Jesse Lingard. Por, pjesëmarrja e mamasë së Pogbas, Yeo Moriba, ka tërhequr vëmendjen e shikuesve.




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | PLYMOUTH - WALSALL | 3+ | FOREST GREEN - GRIMSBY | 1 | ALTRINCHAM - BLYTH SPARTANS | 1 |
|---|---|---|---|---|---|---|

# Haliti: E inkuadroj Dukagjinin në Superligë pastaj pensionohem

Fitim Haliti sot mbush 37 vjet, por nuk e ka ndërmend të pensionohet para se ta inkuadrojë Dukagjinin në Superligë. "Jemi duke punuar maksimalisht për një qëllim të përbashkët, që Dukagjinin ta inkuadrojmë në Superligë. Po mendoj të jam pjesë e këtij suksesi, më pas të pensionohem nga futbolli aktiv. Do të isha i lumtur po të arrija këtë synim, pasi të gjithë futbollistët kanë një ëndërr të tillë para përfundimit të karrierës", ka thënë Haliti

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 JANAR - Futbollisti Fitim Haliti ka një mision të madh para vetës: inkuadrimin e skuadrës së Dukagjinit në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, pastaj pensionimin nga futbolli. Sulmuesi legjendar i skuadrës nga Klina që mbush sot (e martë) 37 vjet ka thënë të hënën për "Epokën e re" se inkuadrimi i skuadrës së Dukagjinit në rangun më të lartë është shumë i sigurt për faktin se ka një skuadër shumë cilësore. "Jemi duke punuar maksimalisht për një qëllim të përbashkët, që Dukagjinin ta inkuadrojmë në Superligë. Po mendoj të jam pjesë e këtij suksesi dhe më pas të pensionohem nga futbolli aktiv. Do të isha i lumtur po të arrija këtë synim, pasi të gjithë futbollistët kanë një ëndërr të tillë para përfundimit të karrierës", ka thënë Haliti.



Në sezonin vjeshtor skuadra e Dukagjinit ka dalë e treta me 33 pikë, pesë pikë më pak se skuadra lidere në Ligën e Parë, Vushtrria. Haliti nuk është shumë i kënaqur me rezultatet e arritura, por është optimist se pranvera do të jetë më e suksesshme për Klubin nga Rrafshi i Dukagjinit. "Të them drejtën nuk jam i kënaqur me pozitën e as me pikët që kemi grumbulluar gjatë vjeshtës. Kemi pasur potencial për rezultate më të mira. Besoj se në pranverë do të jemi më të fortë dhe do të jemi më të sigurt drejt rrugëtimit për inkuadrim në elitë", ka shtuar ai.

I pyetur se cilat skuadra janë konkurrentet kryesore në garë për titull, Haliti ka përmendur vetëm Vëllaznimin dhe Vushtrrinë, kurse ish-skuadrën e vet, Besën nga Peja, e ka përjashtuar nga kjo garë. "Në garë jemi ne, Vëllaznimi dhe Vushtrria. Mos ta harrojmë edhe Vitinë që është afër me pikë. Ndërsa skuadra e Besës po ka probleme dhe më vjen shumë keq që ka ardhur në këtë gjendje, pasi kam luajtur dhe kaluar shumë mirë në këtë klub", ka shtuar ai.

Për stabilitetin e Dukagjinit në këtë kampionat meritor është edhe drejtori i klubit, Fabian Veselaj, i cili është duke u qëndruar afër futbollistëve në çdo aspekt. "Drejtori i klubit ka merita për rezultatet tona. Është duke na qëndruar afër dhe çështja financiare është shumë e rëndësishme kur synohet një sukses. Besoj se në fund do të shpërblehet mundi i drejtorit dhe të gjithëve", ka deklaruar Haliti, i cili ka bërë karrierë edhe në futbollin e Shqipërisë.

# Prishtina merr nga MKRS-ja 10 hektarë për shfrytëzim 40-vjeçar

"Ndihemi jashtëzakonisht të kënaqur që po i ndajmë dhjetë hektarë sipërfaqe Klubit të Futbollit 'Prishtina' për shfrytëzim si një mundësi e madhe për të që të ndërtojë fusha dhe kompleks sportiv si dhe t'i zhvillojë aktivitetet në këtë pjesë. Bërnica e Poshtme do të jetë adresa e re e sportit në kryeqytetin e Republikës së Kosovës", ka thënë ministri Gashi

PRISHTINË, 21 JANAR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi dhe presidenti i Klubit të Futbollit FC Prishtina, Remzi Ejupi, kanë nënshkruar kontratë për shfrytëzim të pronës së paluajtshme përmes së cilës Klubit të Futbollit "Prishtina" i jepet në shfrytëzim për afat prej 40 vjetëve parcela në Zonën Kadastrale Bërnicë e Poshtme me një sipërfaqe prej 10 hektarësh.

FC Prishtina do ta shfrytëzojë këtë hapësirë për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe ndërtimin e fushave sportive dhe kompleksit sportiv deri më 31 dhjetor 2059. Me këtë rast, ministri Gashi u shpreh se ofrimi i kësaj hapësire për klubin e kryeqytetit vjen për shkak të nevojës që ka kryeqyteti për ta ndërtuar infrastrukturën e nevojshme për t'i zhvilluar aktivitetet e ndryshme sportive, me theks futbollit. "Ndihemi jashtëzakonisht



të kënaqur që po i ndajmë dhjetë hektarë sipërfaqe Klubit të Futbollit 'Prishtina' për shfrytëzim si një mundësi e madhe për të që të ndërtojë fusha dhe kompleks sportiv si dhe t'i zhvillojë aktivitetet në këtë pjesë. Bërnica e Poshtme do të jetë adresa e re e sportit në kryeqytetin e Republikës së Kosovës", ka thënë ministri Gashi.

Ndërkaq përfaqësuesi i FC Prishtina, Remzi Ejupi, e falënderoi ministrin Gashi për kontributin dhe angazhimin e treguar në këtë proces i cili është i rëndësisë së veçantë për klubin, futbollistët dhe sportistët kryeqytetas në përgjithësi. "Është sukses i madh për sportistët e Prishtinës dhe i shpreh mirënjohje ministrit Gashi dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për përkrahjen që kanë treguar. Me dhënien në shfrytëzim të kësaj hapësire do të krijohen mundësi të reja për sportin në kryeqytet", ka deklaruar Ejupi.

## U19-shat, për rezultat pozitiv në San Marino

PRISHTINË, 21 JANAR - Përfaqësuesja e Kosovës në futsall për herë të parë këtë vit do të marrë pjesë në kualifikimet për Kampionatin Evropian 2019 në futsall. Kosova është në grup me San Marinon, vendin nikoqir ku do të zhvillohen ndeshjet bashkë me Suedinë dhe Qipron. Përfaqësuesja kishte një grumbullim, ku është bërë edhe përzgjedhja e futbollistëve të cilët do ta bartin barrën e këtij kualifikimi. "Jemi plotësisht të vetëdijshëm që ne veç sa jemi themeluar si përfaqësuese e kësaj grupmoshe dhe nuk kemi pasur shumë kohë të përgatitemi sa duhet dhe sa kërkon kjo garë kualifikuese. Por, sidoqoftë, kemi një atmosferë të këta djem dhe një entuziazëm të jashtëzakonshëm për një paraqitje sa më të mirë dhe dinjitoze. Pra, do ta japim maksimumin tonë dhe tash mbetet të shihet. Por, sido që të jetë, për të gjithë ne kjo do të jetë një përvojë e mirë, edhe pse e dëshirojmë rezultatin e mirë", ka thënë përzgjedhësi Suad Keçi.



## Drita liron portierin Bakajn



GJILAN, 21 JANAR - Portieri nga Shqipëria, Edvan Bakaj, nuk do të jetë më pjesë e skuadrës së Dritës nga Gjilani. Skuadra kampione e Kosovës ka njoftuar se me marrëveshje të dyanshme ka shkëputur bashkëpunimin me portierin Bakaj i cili nuk kishte arritur të përshtatet ashtu siç duhet në skuadrën e Dritës. "Bakaj erdhi në verë nga Liria e Prizrenit, por nuk u përshtat mirë me klubin dhe me marrëveshje të dyanshme janë ndarë rrugët. FC Drita e falënderon Vanin për kontributin e dhënë dhe i dëshiron suksese në karrierë", thuhet në njoftimin e Dritës.

# Sadiku: Refuzova Spanjën dhe Turqinë për Luganon



TIRANË, 21 JANAR - Armando Sadiku u huazua për pjesën e mbetur të sezonit te skuadra e Luganos në Zvicër, aty ku më parë sulmuesi i kombëtares njohu suksesin më të madh. Sadiku për "Supersport" tregoi arsyen e këtij vendimi dhe ndjenjat pas dëmtimit. "Nuk kam pasur fat në Spanjë. Sa shkova pësova një frakturë në hundë e më pas pësova një ulje të formës", ka thënë Sadiku.
Më pas sulmuesi elbasanas rrëfeu për periudhën e dëmtimit dhe fazën e rikuperimit. Ai theksoi se dëmtimi nuk e trembi sepse e kishte kaluar edhe më parë një situatë të tillë, madje te Levante janë surprizuar nga rikthimi i tij në stërvitje brenda katër muajsh. "Kam pasur një sërë ofertash: nga Liga e Dytë spanjolle dhe Turqia. Por, duke qenë se të dyja këto kampionate kanë filluar, mua do të më duhej të rrija një muaj sa të merrja veten, ndërsa në Zvicër kampionati fillon më vonë dhe kjo gjë i shkon për shtat situatës sime. Kam edhe dy vjet kontratë me Levanten, ndërsa te Lugano jam i huazuar deri në gjashtë muaj", ka shtuar ai.
Sulmuesi kuqezi foli edhe për rënia e formës së Kombëtares së Shqipërisë dhe krizën e golit. "Jemi një kombëtare e vogël. Ne krijojmë dy ose tre raste për ndeshje. Unë kam pasur fatin t'i shfrytëzoj në maksimum rastet që më janë dhënë. Për çdo sulmues nuk është e lehtë. Gjatë vitit të kaluar patëm një ulje, por shpresoj që gjatë 2019-s të kthehemi si më parë", ka deklaruar Sadiku.

# Clippersat 'shkelin' San Antonion



San Antonio, 21 janar - Tri ndeshje janë zhvilluar në NBA. Skuadra e Clippersit fitoi 103-95 ndaj San Antonios në fushën e kësaj të fundit, një përballje mes dy ekipesh që synojnë "play-off"-in në Konferencën e Perëndimit. Miqtë nga Los Angelosi dominuan në ndeshje në shumicën e kohës, me Harrisin që realizoi 27 pikë, mbështetur edhe nga Beverley me 18 pikë e 12 rebounde. Pa problem fiton Indiana, që mundi 120-95 Charlotten, suksesi i 31-të sezonal, takim ku vendësit dominuan në fushë dhe e merituan fitoren. U dalluan Oladipo me 21 pikë e Collison me 19. Në sekondat e fundit fiton ekipi i Minnesotas, që mposhti 116-114 Phoenixin, sfidë ku herë udhëhiqte njëra skuadër e herë tjetra. Rose me 31 pikë e Townsi me 30 pikë e 12 rebounde ishte më i miri në fushë.

**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Indiana - Charlotte | 120-95 |
| Minnesota - Phoenix | 116-114 |
| San Antonio - Clippers | 95-103 |

## SHKURT

### Interi pas Hysajt

Skuadra e Interit është duke u interesuar për lojtarin e Kombëtares së Shqipërisë, Elseid Hysajt. E përditshmja sportive "Tuttosport" raporton se futbollisti nga Shkodra po shihet nga drejtuesit e Interit si një zëvendësues i Sime Vrsajlko. Mbrojtësi kroat është i huazuar nga Atletico Madridi, por Interi nuk është i kënaqur me atë që ka treguar nënkampioni i botës, prandaj e dëshiron mbrojtësin shqiptar, Hysaj.

### Serena Williamsi eliminon numrin 1 në botë

Serena Williams ka siguruar një biletë për në çerekfinalet e grand slam të "Australian Open" pas fitores 2-1 (6-1, 4-6, 6-4) në raundin e katërt ndaj Simona Halep, numrit 1 në botë për femra. Një ndeshje e fituar me meritë nga tenistja amerikane, që eliminoi një rivale të drejtpërdrejtë në sfidën për trofe, duke avancuar mes tetë më të mirave. Ndeshja ishte me luhatje nga të dyja tenistet, me Serena që dominoi në setin e parë, ku triumfoi me lehtësi 6-1. Në setin e dytë vjen rikuperimi i Halepit, që rihap ndeshjen pas fitores 6-4, por loja e tenistes rumune ndalet këtu. Në setin e tretë është sërish Serena Williamsi që merr komandën, luan mirë e fiton 6-4, duke avancuar më tej.

### Solari: Reali nuk ka hequr dorë nga titulli

Trajneri Santiago Solari ka konfirmuar se Real Madridi ende nuk është dorëzuar në garën për titull të kampionit, ani pse forma dhe rezultatet në këtë edicion nuk ishin pozitive. "Ne jemi duke luftuar në tri kompeticione deri në fund, si gjithmonë. Për Real Madridin asgjë nuk është e pamundur. Unë gjithmonë e shijoj futbollin dhe konkurrencën. Është pasioni ynë dhe ne e duam, pavarësisht prej kohëve të vështira. Ne jemi të pasionuar pas garës dhe natyrisht se është më mirë ta fitojmë. Askush nuk mund ta mohoj këtë", ka thënë Solari.

### Carrolli kërkohet nga Tottenhami

Tottenham Hotspuri po ka probleme me lëndimin e futbollistëve. "The Sun" raporton se kjo skuadër është duke menduar transferimin e sulmuesit të West Ham Unitedit, Andy Carroll. Lëndimin i Harry Kanes dhe Dele Allit mund të mbulohet përkohësisht nga Carrolli, i cili në të kaluarën ka luajtur edhe për Liverpoolin.

### Dembele mungon dy javë

Francezi Ousmane Dembele është lënduar në ndeshjen që Barcelona e fitoi ndaj Leganes (3-1). Futbollisti në fjalë e shënoi golin e parë në ndeshje, por më pas është lënduar në kyçin e këmbës së majtë, derisa Barcelona ka njoftuar se lojtari do të jetë jashtë fushës për 15 ditë. 21-vjeçari këtë sezon ka shënuar 13 gola në 27 ndeshje, përkundër se sezoni i tij u përcoll me disa probleme me trajnerin Ernesto Valverde.

### Ibra: Pogba i lirë pas largimit të Mourinhos

Ish-futbollisti i Manchester Unitedit, Zlatan Ibrahimoviq, ka thënë se Paul Pogba tashmë po ndihet i lirë pas largimit të Jose Mourinhos nga "Old Trafford". "Janë disa lojtarë që kanë nevojë të jenë të lirë, kanë nevojë të ndihen të lirë të bëjnë atë që munden nën dishepullin e trajnerit. Qartazi, ai i ka taktikat e veta, ai e ka atë, por disa lojtarë shkojnë përtej kufijve të vet. Dhe ju keni nevojë t'i lini të jenë të lirë. Mendoj se Pauli është një nga ta. Pauli nuk ndiente vetëbesim nga trajneri, as trajneri nuk besonte në të", ka thënë Ibrahimoviqi.

**Republika e Kosovës**

Republika Kosovo/Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupstina Opština Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

Mbështetur në Ligjin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144, në Rregulloren QRK Nr.23/2013 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, rregullores komunale për taksa, tarifa ngarkesa dhe gjoba, 01Nr.576 të datës: 28.02.2017, si dhe vendimeve të Kuvendit Komunal të Rahovecit, 01Nr. 1762, 01Nr. 1763, 01Nr. 1764 të datës 30.05.2018 dhe vendimi 01Nr. 3158 të datës: 27.11.2018, Komisioni Vlerësues i ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim i caktuar me vendim të Kuvendit të Komunës së Rahovecit, 01. Nr.595, të dt. 16.02.2018, shpallë këtë:

# NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK

**PËR DHËNIE E PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR**

Njoftim publik për dhënie e pronave të paluajtshme në pronësi të Komunës, përmban si në vijim:

- Parcela Kadastrale nr. P-71510057-03818-0, ne sipërfaqe te përgjithshme 3196 m2 PSH e Kosovës KK Rahovec, me kulturë kullosë e klasës 4, qe gjendet ne vendin e quajtur "Rimnik" ZK Rahovec.
- Parcela Kadastrale nr.P-71510057-03870-0, ne sipërfaqe te përgjithshme 3308 m2, PSH e Kosovës, KK Rahovec, me kulture vreshtë e klasës 3, qe gjendet ne vendin e quajtur: "Rimnik" ZK Rahovec.
- Parcela Kadastrale nr. P-71510057-03871-0, në sipërfaqe te përgjithshme 2767m2 , PSH e Kosovës, KK Rahovec, me kulture kullose e klasës 4, qe gjendet ne vendin e quajtur" Rimnik" ZK Rahovec.
- Parcela Kadastrale nr. P- 71510057-03819-0, ne sipërfaqe te përgjithshme 1159 m2 PSH e Kosovës KK Rahovec, me kulture kullose e klasës 4, qe gjendet ne vendin e quajtur" Seljane", ZK Rahovec.
- Parcela Kadastrale nr. P- 71510057-03710-0, ne sipërfaqe të përgjithshme 616 m2 , PSH e Kosovës, KK Rahovec, me kulture kullose e Klasës 3, që gjendet në vendin e quajtur " Nashpal" ZK Rahovec.
- Parcela Kadastrale nr. P- 71510008-00331-0, ne sipërfaqe të përgjithshme 1037 m2 , PSH e Kosovës, KK Rahovec, me kulture kullose e klasës 6, që gjendet në vendin e quajtur " KALISSHK-TU GRAB" ZK Hoçë e Madhe.

## Afati i dhënies në shfrytëzim:

Afati i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës është afatshkurtër prej **dhjetë (10) vitesh.**

## Veprimtaria që ushtrohet sipas destinimit të pronës:

Shfrytëzimi i pronës së marrë në shfrytëzim mund të shërbej vetëm për **qëllime bujqësore.**

## Çmimi fillestar i pronës që është objekt i dhënies në shfrytëzim përmes ankandit.

Çmimi fillestar për dhënien e pronës në shfrytëzim të tokës bujqësore është i përcaktuar sipas Nenit 10.2 të rregullores komunale për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba 01 Nr.576 të datës 28.02.2017 për dhënien në shfrytëzim të tokë bujqësore.

## Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik dhe data e fundit e dorëzimit të ofertave:

Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik për dhënien e pronave për shfrytëzim afatshkurtër është tridhjetë (30) ditë nga dita e publikimit në ueb-faqen e Komunës, në vendet publike, elektronike dhe të shkruara.

Dokumentacioni për ofertim tërhiqet në zyrën e prokurimit në Rahovec nga data: **16.01.2019, deri me datë: 14.02.2019** në ora: **15:00 h**.

Ofertat dorëzohen të mbyllura në Zyrën e Prokurimit në Rahovec deri me datë: **15.02.2019**, deri në ora: **12:00 h.**

Aplikimi bëhet në zyrën e Prokurimit, çdo ditë pune prej orës **08:00** deri **16:00.**

## Vendi, koha ku do të mbahet ankandi publik:

Në sallën e Kuvendit Komunal, me dt. **15.02.2019,** në fillim në ora: **14:00**, do të bëhet hapja e ofertave të mbyllura dhe të njëjtat do të bëhen publike gjatë hapjes, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në ankand publik.

## Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në ankand publik;

Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik,

- **Personat fizik** krahas aplikacionit në kuvertë duhet të ofrojnë edhe kopjen e letërnjoftimit dhe dëshminë mbi pagesën e tatimit në pronë për gjashtëmujorit të dytë të vitit 2018.
- **Personat juridik**, krahas aplikacionit në kuvertë duhet ta bashkëngjisin
  - I. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me informata mbi biznesin.
  - II. Vërtetimin e taksës komunale në afarizëm,
  - III. Vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës,
  - IV. Vërtetimin e tatimit në pronë për periudhën e gjashtëmujorit të dytë të vitit 2018.

## Pjesëmarrësve në konkurrim iu garantohet e drejta që të:

- Informohen lidhur me procedurat e ankandit publik,
- Shohin pronën që do të jepet në shfrytëzim,
- Kanë qasje në dokumentacionet e pronës,
- Tërhiqen nga ankandi jo më vonë se tre (3) ditë para mbajtjes së ankandit publik.
- Fituesi duhet të nënshkruaj regjistrin e procedurës së ankandit publik. Nëse informatat e dhëna nga ofertuesi dëshmohen si të pasakta, komisioni ka të drejtën që të refuzojë dhënien e pronës në shfrytëzim.

## Raporti i vlerësimit të ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës;

- Komisioni vlerësues brenda tri (3) ditë pune nga përfundimi i vlerësimit të ofertave në ankand publik, harton raportin përfundimtar për përmbylljen e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.
- Raporti përfundimtar i Komisionit vlerësues të ofertave të ankandit publik përmban:
- Një kopje të shpalljes së ankandit publik;
- Procesverbalin e procesit të ankandit publik;
- Rekomandimin e Komisionit për zgjedhjen e fituesit;
- Një kopje të protokolluar të ofertës së përzgjedhur;
- Ankesat e parashtruara nga pjesëmarrësit në ankand publik.
- Pas miratimit të ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues, njoftimi i dërgohet fituesit dhe i njëjti publikohet në tabelën e shpalljeve dhe në ueb - faqen e Komunës. Ofertuesi me çmimin më të lartë të ofruar në pliko të mbyllura do të shpallet fitues gjate procesit te hapjes se ofertave.
- Pala e pakënaqur me vlerësimin e komisionit, ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë komisionit për vlerësimin e ankesave në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh.
- Nëse komisioni i ankesave konstaton se ka shkelje gjatë procesit të vlerësimit ka të drejtë të kërkojë rishqyrtimin e procesit, por nëse komisioni i ankesave vlerëson se nuk ka bazë, atëherë ankesën e refuzon si të pabazuar.
- Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe fituesi i zgjedhur, brenda 15 ditësh pune nga data e miratimit të ofertës nga ana e komisionit vlerësues.

## Vërejtje:

Tërheqja e aplikacioneve për konkurrim në ankand publik bëhet në formë fizike në zyrën e prokurimit në Rahovec.

**Rahovec: 16.01.2019** **Komisioni vlerësues i Ofertave**




MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME / DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES / DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

*DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA*

Bazuar Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, L. nr. 03/L–149, dhe Rregulloren nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

## KONKURS

Titulli i punës: Zyrtar për Promovimin e Turizmit Kulturor
Institucioni: MKRS Prizren
Kategoria funksionale: Koeficienti : 7
Numri i referencës: 03/2019
I përgjigjet: Drejtorit te Departamentit te Kultures
Vendi: Prizren
Lloji i kontratës: "Marrëveshje për shërbime të veçanta" (kohëzgjatje 6 muaj)
Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Departamentit te Kultures, kryen detyrat dhe pergjegjesite e meposhtme:

1. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet me menaxherin dhe stafin tjetër profesional për zbatimin e shërbimeve në fushën e turizmit kulturor;
2. Kryen detyra të specializuara, sipas kërkesës, në fushën e turizmit kulturor, në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
3. Kryen detyrat në fushën e turizmit , me një shkallë të arsyeshme të pavarësisë, me mbikëqyrje dhe udhëzime të kohëpaskohshme;
4. Bën hulumtime dhe analiza sipas kërkesës dhe kontribuon në hartimin e rekomandimeve për shqyrtim nga nivelet më të larta;
5. Merr pjesë në grupe punuese në fushën e turizmit kur kërkohet një gjë e tillë.
6. Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij për shkëmbim të informatave dhe zhvillimin e punës në fushat e interesit të përbashkët;
7. Raporton rregullisht te mbikëqyrësi rreth progresit në lidhje me planet e punës të miratuara;
8. Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

**Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:**

1. Njohuri të thellë në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
2. Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
3. Shkathtësi në komunikim planifikim të punës koordinimi eventual i personelit ;
4. Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
5. Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
6. Diplomë universitare, minimum 2 vite përvojë pune profesionale.

**Procedurat e konkurrimit:** Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët.

**Kohëzgjatja e emërimit**: Emërimi është me afat të caktuar.

**Data e mbylljes së konkursit:** Konkursi është i hapur 8 (tete) ditë.

**Data e fundit e aplikimit është: 29.01.2019**

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacioni mund te shkarkohet nga Web faqja e MKRS-se dhe dorëzohet në zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Tereze" nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211 449 dhe 038 211 921 ( apo në ueb-faqen http://www.mkrs-ks.org/.

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME / DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES / DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

*DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA*

Na osnovu zakona o radu br. 03/L-212, zakona o civilnoj službi Republike Kosova, z. br. 03/L–149, i uredbe br. 02/2010, o procedurama zapošljavanja u civilnoj službi Republike Kosova, Ministarstvo kultue, omladine i sporta objavljuje:

## KONKURS

Naziv radnog mesta: Službenik za Promovisanje Kulturnog Turizma
Institucija:MKOS Prizren
Funkcionalna kategorija: Koeficienat : 7
Broj referencije: 03/2019
Odgovoran je: Direktoru Departmana Kulture
Mesto: Prizren
Vrsta ugovora: "Sporazum o Posebnim Uslugama" (vremensko trajanje 6 meseci)
Zadaci i odgovornosti: Pod nadzorom direktora Departmana za Kulturu, izvršava dole navedene zadatke i odgovornosti:

1. Razvija i postiže saglasnost za planove rada i rokove sa menadžerom i ostalim profesionalnim stafom za sprovođenje dotičnih usluga iz oblasti kulturnog turizma;
2. Izvršava specijalizovane zadatke, prema zahtevu, iz oblasti kulturnog turizma, u podudarnosti sa dotičnim zakonom, pravilnicima, politikama i prosecurama, unutar određenih vremenskih rokova;
3. Izvršava zadatke iz oblasti turizma, sa jednim razložnim stepenom nezavisnosti, sa povremenim nadzorom i uputstvima;
4. Vrši istraživanja i analize prema zahtevu i doprinosi u uređenju uputstava za razmatranje od najviših nivoa;
5. Učestvuje u radnim grupama iz specifične profesionalne oblasti. Kada se tako nešto zahteva.
6. Komunicira unutar institucije i van nje za razmenu informacija i razvoj delatnosti iz oblasti zajedničkog interesa;
7. Redovno izvještava kod nadzornika oko progresa, u vezi prihvaćenih planova rada;
8. Izvršava i svaki drugi zadatak iz specifične, profesionalne oblasti, koji se razložno mogu zahtevati s vremena na vreme.

**Zahtevao obrazovanje, iskustvo, sposobnosti i lične karakteristike:**

1. Duboko poznavanje specifične, profesionalne oblasti, dobijeno preko univerzitetskog obrazovanja i dotičnih treniranja;
2. Poznavanje zakona i pravilnika koji se sprovode;
3. Sposobnost u komuniciranju za planiranje rada, eventualna koordinacija sa radnim osobljem;
4. Sposobnost za istraživanje, analitiku, procenjivanje i formulisanje profesionalnih preporuka i saveta;
5. Sposobnost na kompjuteru, u aplikovanju programa (Word, Excel, Power Point, Access);
6. Univerzitetska diploma, minimum 2 godine profesionalnog radnog iskustva.

**Procedure konkurisanja:** Konkurs je otvoren za sve kandidate.

**Vremensko trajanje imenovanja**: Imenovanje je na određeno vreme.

**Datum zatvaranja konkursa:** Konkurs je otvoren 8 (osam) dana .

**Zadnji datum za aplikovanje je: 29.01.2019**

Aplikacije koje se šalju preko pošte, sa poštanskom markicom, na zadnji dan objave, smatraće se validnim.

**Podnošenje Zahteva:** Aplikacije se preuzimaju sa Ueb stranice MKOS-a, i predaju u kancelariji br. 27 Ministarstva Kulture, Omladine i Sporta, Trg "Majka Tereza" br. 44. Za dodatne informacije kontaktirajte na broj: 038211449 ili 038211921 ( ili na web-stranici http://www.mkrs-ks.org/).

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

# NJOFTIM

## Të gjithë investitorët potencial që planifikojnë të ofertojnë në
## Shitjen 43A
## të aseteve të ndërmarrjeve në Likuidim, njoftohen se:

Dita e dorëzimit dhe hapja e ofertave është: **e mërkurë** **23 janar 2019**, prej orës **10:00 - 12:00**,

**Vërejtje: Njësia në vijim është tërhequr nga Shitja 43A e Aseteve në Likuidim:**

**Njësia nr.33 - Asetet e Luajtshme Rilindja Shtypshkronja**

**DORËZIMI I OFERTAVE**

**në Sallën e konferencave të Hotelit Grand**

## Si duhet të përgatitet oferta:

**OFERTA E JUAJ DUHET TË PËRMBAJ 3 PLIKO (ZARFE).**

Të gjitha dokumentet e ofertës duhet të vendosen në një **pliko (zarf)** të madh e të mbyllur – shih më poshtë: **ZARFI 3**
**Brenda këtij zarfi ( ZARFI 3 ), ju duhet të vendosni dy zarfe të tjera të mbyllura: ZARFI 1 dhe ZARFI 2**

**ZARFI 3**

**OFERTA PËR SHITJEN E ASETEVE NR.........**
Numri i njësisë: ........
Përshkrimi i njësisë: ...................................

**ZARFI 1**

**INFORMATA SHTESË PËR OFERTËN**
(Shitja e Aseteve nr. ....)
Numri i njësisë: ..........
Përshkrimi i njësisë: ...........................

**ZARFI 2**

**ÇMIMI I OFERTËS**
(Shitja e Aseteve nr. ....)
Numri i njësisë: ..........
Përshkrimi i njësisë: ...........................

Dokumentet në vijim duhet të vendosen brenda zarfit
**"Informata shtesë për ofertën"**

1. Dokumentet e cekura në **pikën 8.6. ii** të Rregullave të Tenderit.
2. Origjinalin e formularit për dorëzimin e ofertës - **"SHTOJA C"**, e plotësuar dhe nënshkruar nga ofertuesi.
3. Dëshmi e cila tregon që tarifa për dorëzimin e ofertës është transferuar në llogarinë e AKP-së.
4. Dëshmi e cila tregon që depozita e ofertës është transferuar në llogarinë përkatëse të AKP-së.




**KUJDES, TË PLOTËSOHEN TË GJITHA FUSHAT!**

* Të gjithë ofertuesit potencial të cilët planifikojnë të dorëzojnë ofertën për asetet e përfshira në **Shitjen nr. 43A të Aseteve** janë të obliguar që të përdorin dhe të plotësojnë në tërësi VETËM shtojcat në formatin e përfshirë në Rregullat e Tenderit në fuqi, përndryshe oferta e tyre mund të **DISKUALIFIKOHET!**
**Formularët mund të shkarkohen në ueb faqen e AKP-së apo të tërhiqen në zyrën e marketingut në AKP.**

**LLOGARITË BANKARE PËR LIKUIDIM:**

**Tarifa për dorëzimin e ofertës prej 300 € (treqind Euro) duhet t'i paguhet AKP-së në BQK. Numri i llogarisë është: 1000510000000173**
**Depozita e ofertës duhet t'i paguhet AKP-së në BQK. Numri i llogarisë është: 1000510000000076**

**Për më shumë kontaktoni - Njësinë për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitorë**
**Rr. Agim Ramadani Nr. 23, (ish Rr. Ilir Konushevci Nr.8), 10 000 Prishtinë, Kosovë**
**tel: + 383 (0) 38 500 400 lok. 2004, 1090,1105, ose 1152 / fax: + 383 (0) 38 248 076**
**e-mail: shitja@pak-ks.org ose sales@pak-ks.org; www.pak-ks.org**







# *BeyAb* for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.






Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU
Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
04 Nr.111/01-1919/2019
Kaçanik, 21.01/2019

Në bazë të nenit 5 pika (c) të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, nenit 35 të Ligjit për Arsim Parauniversitar Nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.10/2018 Për Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, shpallë:

**KONKURS**
Për plotësimin e vendeve të lira të punës

**1.Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „Kadri Zeka" në Dubravë:**
Një mësimdhënës i mësimit klasor, zëvendësim (pushim i lehonisë).

**2. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „Agim Bajrami" Satagovë:**
Një mësimdhënës i mësimit klasor zëvendësim (pushim pa pagesë).

**3. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „Idriz Seferi" në Bob :**
Një mësimdhënës i lëndës Edukatë Figurative, me 10 orë, zëvendësim (pushim i lehonisë).

**Detyrat dhe përgjegjësitë për vendet e punës të shënuara më lartë :**

- Të realizoj planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës, në harmoni me legjislacionin në fuqi, që rregullojnë fushat përkatëse për vendin e tij/saj të punës;
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- Të përgatisë me rregull planin mësimor, në përputhje me Kurrikulën Bërthamë.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet kurrikulare;
- Të mbajë ditarin personal të vlerësimit të nxënësve;
- Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës dhe të kryejë me përgjegjësi ekskursionet me nxënës brenda dhe jashtë vendit, sipas udhëzimeve të drejtorit të Shkollës;
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit, të cilit i raporton, dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ia caktojë ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

**Kushtet e pjesëmarrjes në Konkurs:**
Për vendet e punës të shënuar më lartë, kërkohet përgatitja përkatëse profesionale sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT-it.Nr.10/2018 Normativi mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm.
Për aplikim kandidatët duhet të kompletojnë dokumentacionin si në vijim: diploma e fakultetit përkatës, ekstrakti i lindjes, vërtetim për përvojën e punës në arsim dhe kopjen e letërnjoftimit.
Të gjitha dokumentet gjatë aplikimit duhet të jenë kopje, ndërsa origjinali duhet të sjellët në ditën e intervistimit.
**Afati dhe mënyra aplikimit.**
Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar-**Zyra e Pranimit**, kati përdhes.
Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afati nuk do të shqyrtohen.
Kandidatët për seleksionim dhe intervistim do të njoftohen përmes, postës elektronike (e-mail) ose tabelës së shpalljeve publike.
**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik prej 22.01/2019 deri 05.02/2019.**

Drejtori i drejtorisë
Zahir Doda

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E KAÇANIKUT * OPŠTINA KAČANIK * REPUBLIKA KOSOVA

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Albert Tahiraj (më emrin Albert Tahiri në Certifikatën e Gjendjes Martesore) shpall të pavlefshme Certifikatën e Gjendjes Martesore më Nr. Ser. S 10175392 të lëshuar më datë 11.12. 2018 nga Komuna e Mitrovicës.

▶ Merita Beqir Hamidi Cakolli shpallë të pavlefshme diplomën e Kolegjit Iliria Prishtinë me nr.17/14.

▶ Skender Shabani shpall te pavlefshme certifikatën e regjistrimit te biznesit te NTSH "SHABANI TRANS" me NRB 80398123.

▶ Alma Gashi shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Idriz Barani" Klinë e Epërme", Skenderaj.

▶ Unë Fahri Avdiu distancohem nga djali im Bledi Fahri Avdiu dhe nuk marr asnjë përgjegjësi dhe asnjë obligim për veprat e tija, si borgje, vjedhje apo marrje të parasë me fajde. Si dhe njëkohësisht kërkoj nga ju të dëmtuarit që mos të më kontaktoni as në telefonin tim. Me respekt Fahri Avdiu.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi52 000€. Për info 044/672-439.

▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

▶ Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU
Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
04 Nr.111/01-1919/2019
Kaçanik, 21.01/2019

Na osnovu člana 5 (c) Zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo br. 03 / L-068, član 35 Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju br. 04 / L-032, član 8 Zakona o radu br. 03 / L-212, Administrativno uputstvo (MRSZ) Br. 07/2017 o Pravilniku o procedurama javnih konkursa, Administrativno uputstvo MONT-a br. 10/2018 o Normativi o profesionalnom okviru opšteg obrazovanja, Direkcija za obrazovanje i kulturu, objaviti:

OGLAS
Za popunjavanje slobodnih radnih mjesta

1. OŠ "Kadri Zeka" u Dubravi:
Nastavnik razreda, zamjena (porodiljsko odsustvo).

2. Osnovna škola "Agim Bajrami" Satagovo:
Zamjena razrednog učitelja (bez platnih odmor)

3. OŠ "Idriz Seferi" u Bobu:
Nastavnik figurativnog obrazovanja, sa zamjenom od 10 sati (porodiljsko odsustvo).

Dužnosti i odgovornosti za gore navedene poslove:
• Završiti nastavni plan za odgovarajuće radno mjesto, u skladu sa važećim zakonima, koji regulišu relevantna polja za njegovo radno mjesto;
• Obavljanje radnih zadataka osiguravanjem kvaliteta i profesionalne kompetentnosti nastavnog procesa;
• Pravilno pripremiti nastavni plan i program, u skladu sa Osnovnim nastavnim planom i programom.
• Primijeniti nove metodologije nastave i evaluacije u skladu sa smjernicama kurikuluma;
• Održavanje ličnog dnevnika procene učenika;
• Aktivno učestvovati u vanškolskoj organizaciji sa studentima i odgovorno obavljati izlete sa studentima u zemlji i inostranstvu, po uputstvima direktora škole;
• Da poštuje direktnu nadležnost službenog lica kome se javlja i da izvrši dužnosti koje on ili ona mogu dodeliti.
Dužnosti rada moraju biti u skladu sa važećim zakonima.

Uslovi učešća na Oglas :
Za gore navedena radna mesta, neophodna stručna priprema je potrebna u skladu sa Administrativnim uputstvom MONT-a br. 10/2018 o profesionalnom okviru za opšte obrazovanje.
Kandidati moraju popuniti sledeću dokumentaciju: odgovarajuću fakultetsku diplomu, izvod iz matične knjige rođenih, potvrdu o radnom iskustvu u obrazovanju i kopiju lične karte.
Svi dokumenti tokom prijave moraju biti kopije, a original na dan intervjua.
**Rok i način aplikacije.**
Obrasci za prijavu se primaju i dostavljaju Službi za građane - Prihvatilištu, prizemlju.
Dokumenti koji nisu ispunjeni i dostavljeni nakon isteka roka neće se razmatrati.
Kandidati za izbor i intervju će biti obaviješteni putem e-maila ili javnog oglasnog stola.
**Oglas ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u javnim informativnim medijima od 22.01 / 2019 do 05.02 / 2019.**

Direktor Direkcije
z. Zahir Doda

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E KAÇANIKUT * OPŠTINA KAČANIK * REPUBLIKA KOSOVA

Gjej PUNË
• Lajme nga tregu i punes
• Shërbime shkrimi
Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:
- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë
facebook
www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT
SWISS
TAVERNA
Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
Prishtinë


AUTOSHKOLLA
“RITMO – L”
Auto Shkolla
“RITMO - L”
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L